



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 717 Akti

Nr. 749 Vendimi
Tiranë, 27.3.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Genta Tafa (Bungo)	Kryesuese
Suela Zhegu	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 21.3.2024, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dritan Gripshi**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Pika 5 e nenit 179/ b të Kushtetutës, pika 1 e nenit Ç dhe nenet D, DH E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, shqyrtoi të gjithë dokumentacionin e administruar në dosjen e hetimit, si dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
2. Trupi gjykues i shortuar për të shqyrtuar çështjen përbëhet nga komisionerët Suela Zhegu me cilësinë e relatores, Genta Tafa (Bungo) kryesuese dhe Roland Ilia anëtar. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 15.12.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuese e trupit gjykues komisionere Genta Tafa (Bungo). Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatorja e çështjes. Subjekti i rivlerësimit u njoh me anëtarët e trupit gjykues dhe deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit me komisionerët. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar z. Francesco Ciardi.
3. Procesi i rivlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht me nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin, deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
4. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, si: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
5. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar¹, duke konkluduar se:
 - *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
 - *ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
 - *nuk ka kryer deklarim të rremë;*

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2020.

➤ *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

6. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, si dhe ka dërguar një raport² të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit Dritan Gripshi.
7. KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pesë dokumentet e tjera ligjore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar³ mbi subjektin e rivlerësimit.
8. Në vijim, nga relatorja e çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
9. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 22.2.2024, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Dritan Gripshi dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni dhe rezultatet paraprake të hetimit në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
10. Subjekti Dritan Gripshi, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, ka paraqitur shpjegimet dhe provat në datën 20.3.2024. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore të datës 21.3.2024.
11. Për një proces të rregullt ligjor, subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi i janë garantuar të drejtat: (i) për t'u njoftuar për fillimin e procedurës së rivlerësimit; (ii) për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues; (iii) për përfundimin kryesisht të hetimit administrativ, duke i kaluar barrën e provës/shpjegimet mbi rezultatet e hetimit. Subjektit iu dha koha e nevojshme për t'u njohur me dosjen e hetimit dhe për të disponuar kopje të saj, si dhe u njoh me rezultatet paraprake të hetimit administrativ.

II. SEANCA DËGJIMORE

12. Seanca dëgjimore u zhvilluan në datën 21.3.2024, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.
13. Në seancën dëgjimore të datës 21.3.2024, subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi u paraqit dhe u mbrojt vetë, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në

² Raporti nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës për subjektin, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 27.3.2023, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 12.3.2019.

përfundim, subjekti i rivlerësimit pranoi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni dhe kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

14. Subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi ka qenë bashkëpunues gjatë procesit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ, si dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni. Z. Dritan Gripshi ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

15. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.
16. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.
17. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.
18. Ndërsa, sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.
19. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, ka rezultuar se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.
20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:
 - a. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*;
 - b. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
 - c. deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe deklaratat periodike/vjetore të dorëzuara ndër vite nga subjekti në ILDKPKI;

- ç. provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private;
 - d. raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga AKSIK-ja;
 - dh. raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja;
 - e. deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
 - ë. shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të depozituar nëpërmjet postës elektronike dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
21. Bazuar në nenin 179/b, në nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Dritan Gripshi, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, u krye mbi bazën e tri kritereve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; vlerësimi i aftësive profesionale.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

22. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, kreu një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit të kësaj pasurie, të ardhurat, shpenzimet, mundësinë për fshehje të pasurisë dhe deklarim të rremë apo konflikt interesi.
23. Ky hetim është përqendruar mbi të gjitha pasuritë e deklaruara nga z. Dritan Gripshi në deklaratën e pasurisë, shtojca 2, dorëzuar në ILDKPKI në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ku subjekti ka deklaruar pasuritë:
- 24. Njësi në Elbasan, blerë më 19.12.2007, në shumën 2.650.000 lekë, zotërues në masën 100%.**

24.1 Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi për njësinë, kursimet nga pagat e tij dhe bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan më 16.11.2007.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ

24.2 ASHK Drejtoria Vendore Elbasan⁴ ka konfirmuar pasurinë njësi me nr. ***, z. k. ***, vol. **, f. **, në emër të subjektit. Bashkëlidhur kartela e pasurisë dhe kontrata e datës 19.12.2007, ku rezulton se subjekti Dritan Gripshi ka blerë njësi me sip. 48.7 m², lagjja “* Maji”, Elbasan, në vlerën 2.650.000 lekë, e likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale dhe e regjistruar në emër të tij, sipas vërtetimit hipotekor të datës 8.1.2008.

24.3 Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësit e njësisë në Elbasan⁵. Nga informacioni i ardhur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan⁶, Durrës⁷ dhe Berat⁸, nuk është regjistruar ndonjë material kallëzues apo procedim penal në ngarkim të këtyre shtetasve.

⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 27.6.2023.

⁵ Shitësit janë shtetasit: 1. Z.O.T, 2. S.V.T, 3. M.O.T, 4. S.S.T.

⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2023.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 8.11.2023.

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 6.11.2023.

24.4 ISSH⁹ ka depozituar të dhëna për të ardhura të përfituara nga punësimi i rregullt për periudhën janar 2012 e në vijim, për:

- Dritan Gripshi, i punësuar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Berat;
- E.G, e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe ISSH.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie

24.5 Të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie janë:

- i) kursimet nga paga e tij dhe e bashkëshortes;
- ii) të ardhurat nga shitja e apartamentit në datën 16.11.2007, me shumë 5.900.000 lekë.

24.6 Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shtimin e pasurive me blerjen e njësisë, por nuk ka deklaruar burimet për blerjen e saj. Në të njëjtën deklaratë subjekti ka deklaruar edhe shitjen e një apartamenti në datën 16.11.2007, në shumën 5.900.000 lekë.

i) Në lidhje me kursimet nga pagat, në përgjigjet e pyetësorit subjekti ka shpjeguar¹⁰ se: *“Nuk mund të deklaroj me saktësi se sa janë kursimet nga paga që janë përdorur për krijimin e kësaj pasurie, por gjatë vitit është depozituar cash nga shitja e apartamentit vlera 5.900.000 lekë, të cilat janë administruar së bashku me të ardhurat nga pagat apo kursimet e tjera për blerjen e njësisë, shpenzimet për vazhdimin e punimeve të shtëpisë së banimit në shumën 800.000 lekë, sipas deklaramit tim në DPV-në e këtij viti, si dhe për shpenzimet e jetesës.*

Gjithashtu, në vitin 2006, unë kam tërhequr depozitat e kursimit për të kryer punime ndërtimi dhe në fund të vitit 2006 kam harruar të deklaroj kursimet e mbetura nga këto tërheqje”.

ii) Për të ardhurat nga shitja e apartamentit në vitin 2007, rezulton se një pjesë e tyre është përdorur si një nga burimet për blerjen e njësisë në vitin 2007. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti pasurinë apartament me sip. 68 m², në lagjen “* Maji”, Elbasan, e ka blerë me kontratën e shitblerjes datë 16.5.2003, në shumën 500.000 lekë. Subjekti për këtë apartament ka shpjeguar¹¹ se: *“...pasi shita apartamentin e përfituar nga Enti i Banesave, fillova të jetoj tek një apartament në lagjen “* Maji”, Elbasan, i cili ishte në përdorim nga shtetasi S.H, me të cilin kam qenë shok shkolle, bashkëqytetar dhe miq të mirë (në këtë kohë me sa mbaj mend edhe ky apartament ka qenë në procedurë privatizimi). Pasi S ka përfunduar privatizimin dhe regjistrimin e këtij apartamenti unë e bleva këtë apartament në vitin 2003, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.5.2003, në vlerën 500.000 lekë. Si burim për blerjen e këtij apartamenti kanë shërbyer kursimet e mia dhe të bashkëshortes të akumuluar ndërr vite nga paga, si dhe të ardhura të tjera si arkëtimi i shumës 700.000 lekë nga shitja e apartamentit 1+1 në vitin 1998 (siç u shpjegua më sipër) si dhe të ardhurat nga interesat bankare”.*

24.7 Referuar akteve të shitblerjes për këtë pasuri, evidentohet se subjekti 4 vjet pas blerjes së apartamentit, në datën 16.11.2007, e ka shitur këtë apartament në shumën 5.900.000 lekë, paguar cash jashtë zyrës noteriale.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 27.7.2021.

¹⁰ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 20.9.2023.

¹¹ Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ardhur me email-in e datës 20.9.2023.

24.8 Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësit e këtij apartamenti në Elbasan¹². Nga informacioni i ardhur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan¹³, Durrës¹⁴ dhe Berat¹⁵ nuk ka rezultuar e regjistruar ndonjë material kallëzues apo procedim penal në ngarkim të shtetasve të mësipërm dhe të jetë hetuar nga subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi.

24.9 Nga verifikimi i akteve, subjekti këtë apartament e ka blerë në vitin 2003, në shumën 500.000 lekë dhe e shet në vitin 2007, në shumën 5.900.000 lekë, Komisioni ka evidentuar një diferencë të madhe në çmimin e shitjes dhe, për këtë shkak, ka analizuar çmimet e referencës së shitblerjeve të pronave në vitin 2007, për qytetin e Elbasanit. Referuar udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K”, për vitin 2007”, çmimi i referencës së shitjes në tregun e lirë për apartamentet në qytetin e Elbasanit ka qenë në shumën 44.065 lekë/m². Vlera e shitjes së apartamentit duhej të rezultonte në shumën rreth 3 milionë lekë.

24.10 Subjekti gjatë hetimit nuk dha shpjegime në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit, gati 10 herë më shumë nga sa ishte blerë.

24.11 Në lidhje me njësinë në Elbasan, subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga përdorimi i saj nga ndonjë palë e tretë. Pasi u pyet nga Komisioni për destinacionin, subjekti ka shpjeguar¹⁶ se: *“Kjo njësi ka qëndruar e mbyllur për disa vite. Vetëm vitet e fundit është përdorur për magazinim sendesh nga ana e motrës së bashkëshortes, pa qira”*.

24.12 Komisioni analizoi çmimin e blerjes së njësisë në vitin 2007 në shumën 2.650.000 lekë dhe sipas çmimit të referencës¹⁷ do të rezultonte në vlerën 3.218.948 lekë.

Analiza financiare

25. Komisioni kreu analizën financiare në lidhje me mundësinë e subjektit për të blerë njësinë me burime të ligjshme për vitin 2007. Çmimi i njësisë është analizuar sipas çmimit të përcaktuar në kontratë. Analiza financiare e kryer ka rezultuar me balancë pozitive, duke arritur në përfundimin se subjekti ka disponuar burime të ligjshme financiare për të blerë pasurinë “Njësi”.

26. Konstatime të Komisionit për njësinë

26.1 Nga hetimi i kryer rezultoi se:

- Subjekti ka deklaruar saktë pasurinë njësi;
- Subjekti ka disponuar burime të ligjshme për blerjen e saj;
- Subjekti ka blerë njësinë me një çmim më të ulët se çmimi i referencës, për qytetin e Elbasanit;

¹² Që janë shtetasit: 1. S. A.H, 2. A.E.H, 3. H.I.H, 4. Xh.A.H.

¹³ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2023.

¹⁵ Me shkresën nr.*** prot., datë 6.11.2023.

¹⁶ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me email-in e datës 13.11.2023.

¹⁷ VKM Nr. 168, datë 27.3.2019, “Për disa ndryshime në vendim nr. 132, datë 7.3.2018”, Aneksi 2: Çmimet mesatare referuese për metër katror sipërfaqe ndërtimi për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtime dhe ambiente banimi: a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë”.

- Nga hetimi ka rezultuar se apartamenti në lagjen “* Maji”, pasi u përdor nga subjekti 5 vite pa kundërshtëpërbim, më pas në vitin 2003, u ble në shumën 500.000 lekë (dukshëm një çmim më i ulët se çmimi i referencës) dhe u shit 4 vite më pas, në shumën 5.9 milionë lekë;
- Në situatën kur subjekti nuk ka dhënë një shpjegim specifik mbi çmimet e blerjes dhe të shitjes së apartamentit dhe të njësisë, në kushtet kur këto veprime janë të përsëritura, ngrihen dyshime për veprime fiktive me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme për t'i përdorur në vijim për investime në pasuri të paluajtshme.

26.2 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

27. Në prapësimet e depozituara nga subjekti¹⁸ ka pretenduar si vijon:

27.1 Në aktet ligjore të hartuar para noterit për investimet e kryera prej tij në vite, çmimet e përcaktuara në këto akte përfaqësojnë vlerat reale të përcaktuara nga palët dhe shumat e paguar prej gjithsecilit. Ky interpretim vjen në përputhje edhe me praktikën e trajtuara në vendimet nr. 11/2019 dhe nr. 5/2019 të Kolegjit, ku është mbajtur qëndrim se vlera e shitjes së sendeve e pasqyruar në akt noterial përbën vlerë të plotë provuese, duke qenë se çmimi është element thelbësor që përcaktohet nga palët në kontratë.

27.2 Në lidhje me konstatimin e Komisionit se subjekti njësinë me sip. 48.7 m², të ndodhur në lagjen “* Maji”, Elbasan, e ka blerë në çmim më të ulët se çmimi i referencës, subjekti e ka kundërshtuar këtë konstatim, duke shpjeguar se njësinë e ka blerë në përputhje me çmimet e tregut në vitin 2007, referuar kjo edhe zonës ku ndodhej njësia. Subjekti ka shpjeguar se në çmime të përafërta janë shitur edhe pasuri të tjera nga pronarët e tyre në të njëjtin pallat ku ndodhet njësia e blerë nga subjekti, kjo referuar kontratave të depozituara prej tij, ku rezulton se çmimet e shitjes së njësisë janë të përafërta me ato të blerjes nga subjekti, madje ky i fundit ka argumentuar se ka paguar më shumë se blerësit e tjerë, referuar kjo akteve vijuese:

- me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2007, blerësi për njësinë me sip. 42.9 m² ka paguar çmimin në shumën 2.320.000 lekë;
- me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2007, blerësi për njësinë me sip. 36.7 m² ka paguar çmimin në shumën 1.900.000;
- me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 13.6.2007, blerësi për njësinë me sip 29.2 m² ka paguar çmimin e shitjes në vlerën 1.580.000 lekë.

27.3 Subjekti ka shpjeguar se Komisioni ka llogaritur vlerën e njësisë në bazë të VKM-së Nr. 168, datë 27.3.2019, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 132, datë 7.3.2018”, VKM e cila daton shumë vite pas blerjes së kësaj njësie, ndërkohë që njësia është blerë prej tij në vitin 2007. Gjithashtu, subjekti ka kryer rivlerësim të njësisë shumë vite pasi ajo është blerë dhe çmimi i rivlerësimit pas disa viteve është pothuajse i barabartë me atë që përcakton Komisioni.

¹⁸ Në datën 21.3.2024.

27.4 Për konstatimin e Komisionit se për apartamentin në lagjen “* Maji”, me sip. 68 m², i cili u përdor nga subjekti 5 vite pa kundërshtim, në vitin 2003 u ble prej tij në shumën 500.000 lekë, çmim më i ulët se çmimi i referencës dhe 4 vite më pas u shit prej tij në shumën 5.9 milionë lekë (çmim më i lartë se çmimi i referencës), subjekti ka shpjeguar se këtë pasuri ka filluar ta posedojë që në vitin 1997. Ky fakt provohet nga kontrata për furnizim me energji elektrike, e cila u regjistrua në emër të subjektit që prej datës 12.11.1998 deri në vitin 2007, kur u shit nga subjekti.

27.5 Çmimi i blerjes së apartamentit të ndodhur në lagjen “* Maji”, në shumën 500.000 lekë, është dakordësuar me shitësit e këtij apartamenti që në vitin 1997, por nuk formalizohej dot blerja e tij pasi shitësi S.H këtë apartament e kishte ende të paregjistruar në vitin 1997. Subjekti ka shpjeguar se ky apartament është poseduar nga z. H që në vitin 1995, apartament të cilin ky shtetas e përfitoi nga Ministria e Mbrojtjes me autorizim për shkak të statusit të tij si ushtarak. Më pas, ky shtetas ka lidhur marrëveshje me Entin Kombëtar të Banesave dhe është finalizuar blerja e apartamentit me Entin nëpërmjet kontratës¹⁹ së shitblerjes. Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij, ka depozituar një deklaratë noteriale²⁰, lëshuar nga shtetasi S.H, i cili ka konfirmuar pretendimet e subjektit dhe ka pohuar se shumën për shitjen e apartamentit e ka marrë nga subjekti që në vitin 1997, pak muaj pasi subjekti filloi të banonte në këtë banesë.

27.6 Në lidhje me çmimin e blerjes, subjekti ka shpjeguar se ky apartament, pavarësisht se në vendndodhje të mirë, gjendja e tij nuk ka qenë shumë e mirë. Në vitin 1997, çmimet e apartamenteve për një sërë faktorësh kanë qenë shumë të ulëta (përfshirë edhe gjendjen e jashtëzakonshme dhe rënin drastike që kishin pësuar çmimet ndërkohë nga firmat piramidale).

27.7 Në lidhje me çmimin e shitjes së apartamentit në lagjen “* Maji”, në vitin 2007, në shumën 5.900.000 lekë, i cili ka shërbyer si një nga burimet për blerjen e njësisë, subjekti shpjegon se ky çmim është përcaktuar ndërmjet palëve pas kalimit të një periudhe 10-vjeçare, periudhë gjatë së cilës vlera e inflacionit të apartamenteve ka qenë tepër e lartë. Në rastin konkret, vlera e apartamentit është rritur edhe për shkak të përmirësimeve që janë kryer nga ana e subjektit ndër vite, por edhe për shkak të faktit se zona në të cilën ndodhej apartamenti është bërë shumë atraktive me kalimin e viteve. Udhëzimi nr. 2, datë 4.4.2007 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave”, përcakton vlerën mesatare, por çmimet e banesave variojnë nga një sërë faktorësh siç janë vendndodhja, planimetria etj.

27.8 Në seancën dëgjimore të datës 21.3.2024, subjekti, në lidhje me rritjen e vlerës së apartamentit, shpjegoi se gjatë përdorimit të këtij apartamenti për një periudhë 10-vjeçare, 1997 – 2007, kishte kryer disa përmirësime në këtë apartament, në një shumë mesatarisht 8.9 milionë lekë, shumë e cila nuk ishte deklaruar prej tij gjatë hetimit administrativ. Këto shpenzime për përmirësimin e apartamentit të deklaruar nga subjekti janë përfshirë në analizën financiare të kryer nga Komisioni pas seancës dëgjimore.

27.9 Subjekti ka shpjeguar se Komisioni duhet të këtë parasysh se prej tij është vepruar në mënyrë të ngjashme edhe me shitjen e një apartamenti tjetër me sip. 49.8 m², në Elbasan, të cilin e kishte përfutuar nga Enti Kombëtar i Banesave. Ky apartament është shitur *de facto*

¹⁹ Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2002.

²⁰ Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.2.2024.

prej subjektit në vitin 1998, por kontrata formale e shitjes është përpiluar në vitin 2006 dhe çmimi në kontratë është shënuar 700.000 lekë, aq sa subjekti ka arkëtuar nga shitja e këtij apartamenti në vitin 1998. Ky apartament i është shitur pa kontratë formale shitjeje në vitin 1998 shtetasit F.Ç, veprim i cili është dokumentuar në aktmarrëveshjen e datës 9.4.1998, kopjen e së cilës subjekti shpjegon se e ka vënë në dispozicion të Komisionit gjatë hetimit administrativ.

27.10 Subjekti shpjegon se ka vepruar në të njëjtën mënyrë si për apartamentin e blerë *de facto* në vitin 1997 dhe atë të shitur *de facto* në vitin 1998, me çmime të përafërta, tregon se çmimet në kontratat formale si në atë të blerjes në vitin 2003 dhe në atë të shitjes në vitin 2006, tregojnë tej çdo dyshimi vërtetësinë e deklarimeve të tija mbi vlerën reale të blerjes dhe shitjes së këtyre apartamenteve, por edhe kohën kur këto apartamente, përkatësisht janë blerë dhe shitur prej tij.

27.11 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se në vitin 2006 është bërë kontrata formale e shitjes me shtetasin F.Ç dhe çmimi në kontratë është shënuar ai i dakordësuar në vitin 1998. Ky fakt kundërshton dyshimin e Komisionit për veprime fiktive me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme sepse në kontratat e kryera formalisht në vitet 2003 dhe 2006 (respektivisht blerja dhe shitja e apartamentit) janë përcaktuar çmimet e dakordësuara ndërmjet palëve shumë vite më parë. Çmimet në kontratat e shitblerjes janë përcaktuar me vullnet të lirë ndërmjet palëve ashtu siç janë përcaktuar në kontratat e shitblerjes.

27.12 Për sa më sipër, bazuar në provat dhe argumentet bashkëlidhur këtyre prapësimeve rezulton se subjekti ka vërtetuar të kundërtën e barrës së provës mbi gjetjet e njoftuara nga Komisioni.

27.13 Në lidhje me shtëpinë që subjekti dispononte në Elbasan, të cilën pretendon se e ka shitur në vitin 1998 në shumën 700.000 lekë, ka depozituar deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2024, sipas së cilës nëna e subjektit H.G ka deklaruar se: “*Sipas ligjit kemi qenë bashkëpronarë në shtëpinë në Elbasan, ajo pasuri ka qenë e destinuar sipas vullnetit tim dhe të bashkëshortit tim për të qenë në pronësi të djalit tonë Dritan Gripshi. Dhe pas shitjes së saj me aktmarrëveshjen e vitit 1998, si dhe me formalizimin e saj me kontratën e vitit 2006, e gjithë shuma prej 700.000 lekësh është përfituar prej tij*”. Ky pretendim është në nivel deklarativ dhe i pambështetur me dokumentacion të kohës.

Vlerësimi i Komisioni për njësinë

28. Komisioni, pas analizimit të pretendimeve të subjektit, akteve të depozituara prej tij, si dhe në vlerësim të të gjithë dokumentacionit të administruar vëren se:

28.1 Në lidhje me konstatimin e blerjes së njësisë nga subjekti në çmim më të ulët se çmimi i referencës, subjekti me provat e depozituara arriti të provojë që në çmime të përafërta ishin shitur edhe “njësi” të tjera, me palë të njëjtët pronarë dhe në të njëjtin pallat. Në vijim, referuar një vërtetimi pronësie me datë 20.9.2022, lëshuar nga ASHK Drejtoria Vendore Elbasan, rezulton se njësia, 10 vite pasi është blerë nga subjekti në vitin 2017, është rivlerësuar në shumën 3.674.415 lekë. Nga këto fakte, trupi gjykues krijoi bindjen se blerja e njësisë në shumën 2.650.000 lekë përfaqëson çmimin e tregut për njësinë e blerë nga subjekti.

28.2 Në lidhje me shtëpinë e subjektit me sip. 68 m², e cila u ble nga subjekti në shumën 500.000 lekë dhe u shit në shumën 5.9 milionë lekë, Komisioni vëren se subjekti provoi se

këtë shtëpi e ka poseduar që në vitin 1998, kjo referuar vërtetimit nr. *** prot., datë 29.1.2024, lëshuar nga FSHU Elbasan, sipas të cilit rezultoi se subjekti ka pasur të regjistruar në emër të tij një kontratë për furnizim me energji elektrike që prej datës 12.11.1998. Subjekti ka formalizuar kontratën e blerjes së kësaj pasurie në vitin 2003 dhe fakti që ka pasur kontratën e furnizimit me energji elektrike që në vitin 1998 është element provues që e ka poseduar këtë shtëpi sipas pretendimeve të tij. Gjithashtu, duke qenë se subjekti e ka poseduar këtë apartament edhe pa pasur një marrëdhënie të formalizuar shitblerjeje me pronarin e saj S.H, për Komisionin është i pranueshëm pretendimi i subjektit që çmimi i blerjes së saj ishte dakordësuar që në vitin 1997, kur filloi ta përdori atë edhe për faktin që pronari S.H në atë periudhë nuk e kishte regjistruar ende në emër të tij apartamentin dhe ishte në pamundësi për ta formalizuar shitjen. Për efekt të analizës financiare, Komisioni pranoi pretendimin e subjektit që pagesa për blerjen mund të jetë kryer në vitin 1997 dhe jo në vitin 2003, sipas kontratës formale të shitblerjes. Komisioni e reflektoi këtë ndryshim në analizën financiare, si shpenzim të kryer në vitin 1997, duke e hequr si shpenzim në vitin 2003.

28.3 Në lidhje me faktin se subjekti e ka shitur apartamentin në lagjen “* Maji”, në vitin 2007, në shumën 5.9 milionë lekë, i cili ka shërbyer si një nga burimet për blerjen e njësisë, Komisioni, pavarësisht dyshimeve të ngritura për efekt të analizës financiare, në analizën e shifrave ka referuar çmimin sipas kontratës noteriale të shitblerjes datë 16.11.2007, pra në vlerën e plotë të saj.

28.4 Subjekti gjatë hetimit administrativ është pyetur nëse ka kryer ndonjë përmirësim apo investim në këtë pasuri, e cila ia kishte rritur vlerën me 10-fish, por ai nuk ka dhënë detaje. I pyetur nga paneli në seancën dëgjimore të datës 21.3.2024, subjekti ka deklaruar për herë të parë se gjatë viteve ka kryer disa përmirësime në këtë apartament, në shumën deri në 1.000.000 lekë, të cilat Komisioni vendosi t’i reflektojë në analizën financiare të subjektit, të shtrira në vite përgjatë periudhës 1997 – 2006, në shumën totale 1.000.000 lekë ose rreth 100.000 lekë/vit, në kushtet kur subjekti nuk mund të provojë saktësisht këto shpenzime të kryera në vite.

28.5 Përfundimisht, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar me vërtetësi pasurinë njësi të ndodhur në qytetin e Elbasanit dhe ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e saj, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

29. Tokë/arë me sipërfaqe 450 m², në Sauk, Tiranë, blerë në shumën 1.950.000 lekë. Zotëruar nga subjekti në masën 100%.

29.1 Si burim krijimi për këtë pasuri janë deklaruar:

- i) kursimet nga pagat;
- ii) hua e marrë nga shtetasi S.V.

Hetimi i Komisionit

29.2 ASHK²¹ ka konfirmuar pasurinë në emër të subjektit me nr. **, vol. **, f. **, z. k. ***, lloji i pasurisë arë, me sip. 450 m², blerë nga shtetasi B dhe M.B, me kontratën e shitblerjes nr. ***rep., nr. *** kol., datë 24.12.2005, në shumën 1.950.000 lekë.

²¹ Me shkresën nr. ***a prot., datë 5.3.2018, përcjell përgjigjen e ZVRPP Tiranë, drejtuar ILDKPKI-së.

29.3 QKB²² konfirmon se shtetasi S.V (i datëlindjes 1955) figuron i regjistruar në QKB si person fizik me NUIS (NIPT) K***H, është regjistruar me vendimin nr. 02, datë 9.4.2004, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

29.4 Komisioni ka hetuar në lidhje me ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me shitësit e tokës të blerë në Sauk, Tiranë²³. Nga informacioni i ardhur nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan²⁴, Durrës²⁵ dhe Berat²⁶ ka rezultuar se nuk është regjistruar ndonjë material kallëzues apo procedim penal në ngarkim të shitësve të pronës.

Hetimi për huadhënësin S.V

29.5 Në përputhje me nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kërkoi subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues mbi të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, me qëllim analizimin e mundësisë financiare të tij deri në masën e huas në shumën 1.200.000 lekë, si dhe kreu një hetim mbi të ardhurat e ligjshme të realizuara nga aktiviteti privat.

29.6 Nga hetimi i Komisionit, DRT Elbasan²⁷ ka informuar se shtetasi S.V figuron i regjistruar me NIPT K***H, si person fizik. Ky tatimpagues është me status pasiv nga data 25.7.2011 dhe ka të dhënat: data e regjistrimit 4.2.2004. Tatimpaguesi ka deklaruar deklaratën për tatim-fitimin e thjeshtuar mbi fitimin, vitet 2005, 2006 dhe 2007, bashkëlidhur, sipas të cilave, të ardhurat dhe fitimi për vitin 2005 janë 0 (zero) lekë.

29.7 DRT Elbasan ka depozituar edhe kopje të deklaratave të kontributeve të sigurimeve shoqërore për çdo tremujor të periudhës 2005 – 2007, nga ku duket se gjatë vitit 2005 huadhënësi ka deklaruar vetëm pagë minimale.

29.8 Komisioni ka hetuar për ndonjë konflikt të mundshëm interesi të subjektit me huadhënësin S.V, për të cilin nuk rezultuan të dhëna.

Burimi i krijimit

30. Burimet e ligjshme të subjektit

30.1 Në lidhje me burimin e krijimit për blerje të truallit në deklaratën *Vetting* janë deklaruar: (i) kursimet nga paga; (ii) një hua e marrë nga shtetasi S.V, me deklaratën noteriale nr. ***, datë 15.12.2005.

30.2 Në DPV-në e vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar burim për blerjen e truallit, por tek seksioni i detyrimeve financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë ka deklaruar: “*Marrë një hua për blerje të truallit me sip. 450 m² në shumën 1.200.000 lekë sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 15.12.2005*”.

30.3 Në lidhje me kursimet e përdorura për blerjen e truallit, subjekti ka shpjeguar²⁸ se: “*Referuar DPV-së së këtij viti, kursimet janë të vitit 2005, pra bashkë me bashkëshorten kemi kursyer shumën 800.000 lekë nga të ardhurat nga paga dhe së bashku me huan e marrë*

²² Me shkresën nr. *** prot., datë 26.10.2023.

²³ Shtetasit B.K.B dhe M.A.B.

²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 30.10.2023.

²⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 8.11.2023.

²⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 6.11.2023.

²⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2023.

²⁸ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 20.9.2023.

shtetasit S.V kanë shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie në fund të vitit. Nuk kam pasur kursime cash në fund të këtij viti. Çdo kursim i akumuluar nga viti 2004 dhe 2005 është shpenzuar gjatë këtij viti”.

30.4 Subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore në lidhje me shumën *cash* të deklaruar në vitin 2005, pasi referuar DPV-së së vitit 2005, si dhe procesverbaleve me të cilat është pyetur subjekti në ILDKPKI, ka deklaruar se kjo shumë është mbartur deri në vitin 2007 si shumë totale e gjendjes *cash*, kurse gjatë hetimit deklaroi se kjo shumë është përdorur në dhjetor të vitit 2005, brenda të njëjtit vit për blerjen e truallit.

31. Burimet e huadhënësit

31.1 Në lidhje me burimet e ligjshme të huadhënësit S.V, subjekti ka shpjeguar²⁹ se: *“Huan e kam marrë vetëm për pak muaj për shkak se kursimet e mia ndodheshin në depozitë, të cilat janë tërhequr gjatë vitit 2006. Prandaj në deklaratë kam deklaruar se shuma do kthehet brenda katër muajve (këtë afat e kam lidhur me maturimin e depozitave të kursimit).*

Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur disa dokumente tatimore që tregojnë ushtrimin e aktivitetit nga ana e huadhënësit si person fizik “S.V”, me objekt të veprimtarisë transport mallrash.

Sqaroj se në muajin mars të vitit 2004 i kam transferuar vjehrrit tim në llogarinë e tij në Alpha Bank shumën 3.271.123 lekë për shkak se ai kishte aplikuar për marrjen e një vize amerikane³⁰. Këto para vjehrrit i ka investuar në depozitë kursime (për llogarinë tonë) me qëllim që të krijonin interesa dhe në janar të vitit 2006 i ka tërhequr (principalin + interesat e krijuar) dhe na i ka dorëzuar cash për shkak se ne na nevojiteshin për kryerjen e punimeve për ndërtimin e shtëpisë, si dhe kam shlyer huan e shtetasit S.V siç kam deklaruar në DPV-në e vitit 2006.

Unë kam deklaruar në DPV-në e vitit 2006 tërheqjen e shumës së kësaj depozite duke shënuar edhe numrin e llogarisë së kësaj depozite, e cila edhe pse është në emër të vjehrrit, këto para i janë kaluar nga ne në vitin 2004, me transaksion bankar. Ai ka tërhequr shumën e kaluar nga ana jonë, si dhe interesat që depozita ka krijuar.

Këto likuiditete kanë si burim kursimet e mia dhe të bashkëshortes të krijuara në vite me burim: (i) të ardhurat nga pagat, (ii) nga interesat bankar; (ii) nga shitja e apartamentit në vitin 1998, por me sa mbaj mend edhe (iv) para të përfituara nga investimi në firmat piramidale (jam në kërkim të dokumentacionit)”.

31.2 Në përgjigje të pyetësorit³¹, për të ardhurat e realizuara nga firmat piramidale, subjekti ka depozituar një deklaratë noteriale³² të lëshuar nga shtetasi S.E, i cili deklaroi se në periudhën prill 1996 – janar 1997 ka qenë i punësuar pranë fondacionit bamirës “***”, me detyrë drejtor i filialit Peqin. Ky shtetas ka deklaruar se: *“Mandatet vijuese me:*

*- nr. ***, datë 30.12.1996, në shumën 288.000 lekë, i cili ka si origjinë mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.9.1996, në shumën 90.000 lekë;*

²⁹ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 20.9.2023.

³⁰ Subjekti në përgjigje të pyetësorit ardhur me *email*-in e datës 30.1.2024, ka depozituar 2 viza amerikane lëshuar për vjehrrin e vjehrrën e tij, B dhe Z.I, të vlefshme për periudhën 27.5.2005 – 26.11.2005.

³¹ Ardhur me shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2024.

³² Me nr. *** rep., nr. ** kol., datë 24.1.2024.

- nr. ***, datë 30.12.1996, në shumën 288.000 lekë, i cili ka si origjinë mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.9.1996, në shumën 90.000 lekë;
- nr. ***, datë 30.12/1996, në shumën 288.000 lekë, i cili ka si origjinë mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.9.1996, në shumën 90.000 lekë; të tria mandatet janë plotësuar dhe nënshkruar prej tij, në cilësinë e drejtorit të filialit dhe të gjitha shumat në këto mandate janë depozituar në filialin e degës Peqin nga shtetasi Dritan Gripshi dhe janë tërhequr po prej tij në datën 30.12.1996 po nga Dritan Gripshi”.

31.3 Nga Komisioni u evidentua se gjatë hetimit subjekti nuk provoi me ndonjë dokument se shtetasi S.E ka mbajtur detyrën e drejtorit të filialit Peqin, sipas deklarimeve të tij. Nga analizimi i të tre mandateve të depozituar nga subjekti rezultoi se vetëm mandati nr. ***, datë 30.12.1996, rezultoi t’i jetë paguar shtetasve B.K (30), M.K (30) dhe Dritan Gripshi (30) shuma e lekëve 288.000 lekë, si fitim për shumën e arkëtuar 90.000 lekë.

31.4 Referuar mandatit nr. ***, datë 30.12.1996, rezultoi t’i jetë paguar shtetasve E.G (30), M.G (30) dhe N.G (30) shuma e lekëve 288.000 lekë, si fitim për shumën e arkëtuar 90.000 lekë.

31.5 Kurse mandati tjetër nr. ***, datë 30.12.1996, rezultoi t’i jetë paguar shtetasve A.G (30), F.G (30) dhe një shtetasi tjetër (30) shuma e lekëve 288.000 lekë, si fitim për shumën e arkëtuar 90.000 lekë.

31.6 Të gjitha faktet e cituara më sipër në lidhje me të ardhurat e realizuara nga firmat piramidale, mbetën në nivel deklarativ dhe pa prova të tjera të kohës që të shkojnë në favor të subjektit.

31.7 Subjekti, në mbështetje të shpjegimeve të tij ka depozituar dokumentacion³³ provues, ndërmjet të cilave edhe deklaratën noteriale të shtetasit S.V, të datës 15.12.2005, e cila përputhet me deklaratimet e subjektit. Në lidhje me burimet e ligjshme të të ardhurave të huadhënësit S.V subjekti ka depozituar shpjegime shtesë³⁴ ku ka deklaruar se: “Z. S.V është banor i fshatit B, Njësia Administrative Sh, Bashkia Elbasan dhe është pronar i sipërfaqes gjithsej 8750 m², të përfutur sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, të ndryshuar. Në këtë sipërfaqe z. V ka zhvilluar aktivitet bujqësor dhe frutikulturë (hurma, mushmolla dhe vreshtë) dhe ka paguar rregullisht taks tarifave familjare të përcaktuara”.

31.8 Subjekti, në vijim të këtyre shpjegimeve për huadhënësin, ka depozituar dokumentacion provues³⁵, i cili u analizua nga Komisioni. Nga verifikimi i këtyre akteve nuk rezultoi që z.

³³ Bashkëlidhur:

- deklaratën noteriale të shtetasit S.V, të datës 15.12.2005.
- disa dokumente tatimore që tregojnë ushtrimin e aktivitetit nga ana e tij si person fizik “S.V”, me objekt të veprimtarisë transport mallrash.

³⁴ Ardhur me email-in e datës 22.12.2023.

³⁵ Bashkëlidhur ju dërgoj:

- aktin e ekspertimit për të ardhurat neto të përfutur nga aktiviteti bujqësor dhe frutikulturë të zhvilluar mbi sipërfaqen e lartpërmendur deri në dhjetor 2005;
- certifikatë për vërtetim pronësie, numri i pasurisë ***, për sipërfaqen 4358 m²;
- certifikatë për vërtetim pronësie, numri i pasurisë ***, për sipërfaqen 3351 m²;
- certifikatë për vërtetim pronësie, numri i pasurisë ***, për sipërfaqen 542 m²;
- certifikatë për vërtetim pronësie, numri i pasurisë ***, për sipërfaqen 451 m²;
- (arë +truall);
- vërtetim nr. *** prot., datë 12.12.2023, lëshuar nga Njësia Administrative Sh;
- vërtetim i Njesisë Administrative Sh lidhur me taks-tarifave familjare.

V të ketë realizuar të ardhura të ligjshme në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza financiare

32. Komisioni ka kryer analizën financiare për të analizuar mundësinë e huadhënësit për dhënien e huas në shumën 1.200.000 lekë në datën 15.12.2005.

Analiza financiare e huadhënësit për shumën 1.200.000 lekë

32.1 Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe hetimit për huadhënësin S.V, ka rezultuar se nuk janë provuar të ardhura për periudhën përpara dhënies së huas subjektit.

32.2 Nga verifikimi i dokumentacionit ka rezultuar se gjatë vitit 2005 huadhënësi ka deklaruar vetëm kontribute për një pagë minimale çdo tremujor të vitit 2005. Nga verifikimi i të dhënave bankare, gjithashtu, nuk ka rezultuar që shtetasi S.V të ketë pasur gjendje në llogari bankare apo transaksione (tërheqje *cash*) në sistemin bankar deri në dhjetor 2005.

32.3 Nga hetimi i Komisionit:

- Huadhënësit ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për të dhënë huan subjektit në shumën 1.2 milionë lekë, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, për pasojë huaja nuk u përfshi në analizën financiare të subjektit si burim për blerjen e truallit.
- Nga verifikimi i statementit bankar, përputhet deklarimi i subjektit, i cili ka shpjeguar se për shlyerjen e huas dhe ka pasur si burim mbylljen e depozitës në Alpha Bank dhe tërheqjen e shumës 3.540.700 lekë në datën 20.1.2006.

Analiza financiare e subjektit në dhjetor të vitit 2005, në momentin e blerjes

33. Komisioni kreu analizën financiare për vitin 2005, nga ku subjekti rezultoi me një balancë negative në shumën 2.383.032 lekë.

Konstatime të Komisionit

34. Në lidhje me blerjen e truallit me sipërfaqe 450 m²

34.1 Subjekti rezultoi me balancë negative në shumën 2.383.032 lekë pasi:

- nuk ka disponuar mjaftueshëm të ardhura për të krijuar kursimet nga pagat, në shumën 750.000 lekë;
- nuk ka disponuar mjaftueshëm të ardhura për të krijuar në fund të vitit 2005 gjendjen *cash* prej 800.000 lekësh, të deklaruara si gjendje në DPV-në e vitit 2005 (pra, gjendje më 31.12.2005);
- nga analiza financiare ka rezultuar se huadhënësi nuk ka disponuar mjaftueshëm burime të ligjshme për dhënien e huas në shumën 1.2 milionë lekë.

34.2 Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

35. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e depozituara në datën 20.3.2024 ka pretenduar si vijon:

35.1 Në lidhje me huan e marrë nga shtetasi S.V, subjekti ka shpjeguar se huadhënësi ka disponuar mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për të dhënë huan, e cila është dokumentuar me deklaratë noteriale në vitin 2005 dhe është deklaruar rregullisht në deklaratën e pasurisë së vitit 2005 ashtu edhe në deklaratën *Vetting*. Për të vërtetuar ushtrimin e aktivitetit nga huadhënësi, subjekti ka depozituar një shkresë³⁶, lëshuar nga shoqëria “K.I” sh.a. për realizimin e disa punimeve të hidroizolimit, të kryera nga shtetasi S.V në periudhën 2004 – 2010. Kjo shoqëri referon se në vitin 2004, z. V ka kryer shërbime si riparime të ndryshme e hidroizolime të godinave dhe vlera e situacionit është 1.070.720 lekë. Në vitin 2005, vlera e situacioneve për punimet e kryera ka qenë në shumat 353.220 lekë dhe 775.000 lekë, gjithsej 1.128.22 lekë. Shoqëria “K.I” sh.a. deklaron se volumet e punimeve janë nxjerrë bazuar në të dhënat e shoqërisë, si dhe detyrimet ndaj personit fizik janë kryer sipas situacioneve dhe faturave përkatëse.

35.2 Subjekti shpjegon se sikurse evidentohet nga shkresa lëshuar nga shoqëria “K.I” sh.a., vetëm qarkullimi i realizuar nga punimet e kryera në këtë shoqëri janë në shumën mbi 1.000.000 lekë/vit. Pavarësisht se deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin janë deklaruar zero, sipas qëndrimit të mbajtur edhe nga audituesi ligjor në aktin e tij të ekspertimit, subjekti ka shpjeguar se referuar legjislacionit të kohës, ky nuk ka qenë një detyrim për deklarim për tatimpaguesit me qarkullim deri në 2.000.000 lekë.

35.3 Duke mbajtur parasysh se në kushtet kur provohet se huadhënësi ka pasur qarkullim me të paktën një klient në shumën mbi 1.000.000 lekë/vit, kur personi fizik nuk ka detyrime tatimore dhe ka qenë i regjistruar si tatimpagues në fillim të vitit 2004, audituesi ligjor ka konkluduar se fitimi neto duhet të përlllogaritet në masën 30% për qarkullimin deri në kufirin 2.000.000 lekë. Për vitet 2004 dhe 2005, bazuar në marzhin e aktivitetit të ushtruar, i cili bazuar në analizën e sektorit konsiderohet të merret 30%, fitimi neto për nivelin e qarkullimit deri në 2.000.000 lekë do të jetë 600.000 lekë/vit.

35.4 Për vitet 2004 dhe 2005, bazuar në marzhin e ushtrimit të aktivitetit dhe nivelit më minimal të xhiros, në mungesë të të dhënave të tjera do të rezultonte një fitim neto në shumën 1.200.000 lekë, që është e barabartë me shumën e dhënë hua. Në përlllogaritje, pavarësisht se merret në konsideratë vetëm fitimi neto i realizuar, duhet të mbahet parasysh edhe mundësia financiare e flukseve monetare në datën e dhënies së huas, që një pjesë e detyrimeve për sigurimet shoqërore dhe të tjera nuk janë paguar deri në fund të vitit 2005 (pasi paguhen në janar 2006).

35.5 Në vijim subjekti, për të provuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit, referon se nëpërmjet dokumentit “Vërtetim për bazën e vlerësuar” janë konfirmuar pagesat e kontributeve për vitet 2004, 2005 dhe 2006 për shtetasin S.V.

35.6 Subjekti ka pretenduar gjithashtu se përveç të ardhurave nga ushtrimi i aktivitetit, shtetasi S.V ka përfituar edhe të ardhura nga toka bujqësore. Referuar aktit të ekspertimit të përgatitur nga eksperti³⁷ janë përlllogaritur të ardhurat nga toka bujqësore në çdo vit kalendarik. Toka bujqësore rezulton të jetë e regjistruar në disa certifikata pasurie. Në vijim të këtyre shpjegimeve, subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit qëndrimet e mbajtura nga Komisioni dhe Kolegji për të ardhurat e realizuara nga toka bujqësore, ku tashmë ka një

³⁶ Me nr. *** prot., datë 12.3.2024.

³⁷ B.Ç.

praktikë të konsoliduar. Kështu, në vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 4.2.2020, Komisioni trajton si të ardhura të ligjshme të ardhurat e siguruara nga toka bujqësore prej prindërve të subjektit.

35.7 Në vendimin nr. 20/2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në të cilin theksohet se: *“Në kushtet e mungesës së një dokumentacioni të plotë mbi masën reale të të ardhurave të përfituara nga shfrytëzimi i ullishtave, trupi gjykues mban në konsideratë faktin se pronësia e babait të subjektit të rivlerësimit me mbi 125 rrënjë ullinj (25 janë rrënjë shekullore dhe 100 rrënjë të reja), është e provuar me AMTP nr. {***} të vitit 1993 dhe formularin nr. {***}, datë 8.4.1993... Në përfundim, sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vendosi të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e përfituara nga ullishtat, sipas llogaritjeve në raport vlerësimi për të ardhurat nga ullishtat e H. M., datë 10.12.2019, pasi çmon se provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat e familjes M., në harmoni me njëra-tjetrën, provojnë bindshëm që kjo familje ka përfituar në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë të ardhura nga shfrytëzimi i ullishtave”.*

35.8 Në përmbledhje të shpjegimeve të mësipërme, vlerësuar këto në harmoni me provat e reja të depozituara prej tij, pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegon se ndryshe nga sa ka konstatuar Komisioni, rezulton që z. V ka disponuar mjaftueshëm të ardhura për të dhënë huan, pasi me provat e depozituara është provuar se huadhënësi ka realizuar të ardhura të ligjshme, në zbatim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

35.9 Subjekti ka kundërshtuar analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2005, duke shpjeguar se këtë vit janë përfshirë shpenzimet mjekësore të vajzës, të cilat, ashtu siç rezulton nga dokumentacioni bashkëlidhur këtyre prapësimeve, janë paguar në vitin 2006 dhe jo në vitin 2005. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se shpenzimet e udhëtimit për kurimin e të bijës, në vitin 2005, në Turqi, duhet të reduktohen për shkak se ai me familjen kanë qëndruar në shtëpinë e kushëririt shtetasi A.G, banues në Stamboll. Në mbështetje të pretendimeve të subjektit, shtetasi A.G ka lëshuar edhe një deklaratë noteriale³⁸ ku konfirmon pretendimet e subjektit dhe, për këtë arsye, shpenzimet e qëndrimit në Turqi duhet të përlllogariten sipas metodologjisë të përdorur nga Kolegji në vendimin nr. 12/2019.

35.10 Gjithashtu, në lidhje me analizën financiare subjekti ka shpjeguar se në DPV-në e vitit 2005 ka deklaruar kursim nga pagat e vitit, po këto kursime ashtu siç ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe gjatë hetimit administrativ janë përdorur në fund të vitit si burim për të blerë pasurinë tokë /arë³⁹ me sipërfaqe 450 m², në Sauk. Në vijim, subjekti shpjegon se është e vërtetë që është pyetur në ILDKPKI në vitin 2008 për gjendjen *cash* në fund të vitit 2007, ku është deklaruar gjendja *cash* në shumën 3.050.000 lekë, gjendje (pra, shumën e përgjithshme) të cilën e ka konfirmuar gjithmonë, edhe e konfirmon edhe në këto prapësime, por në këtë gjendje ashtu siç referohet edhe në deklaratën e pasurisë së vitit 2007 këto kursime kanë si burim të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit, si dhe kursimet nga pagat e

³⁸ Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.3.2024.

³⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës:

- kontratë shitje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.12.2005, ku Dritan Gripshi blen tokë arë në Sauk, me sip. 450 m² në vlerën 1.950.000 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale;
- certifikatë për vërtetim pronësie datë 12.1.2006 për tokë arë në Sauk, me sip. 450 m², në emër të Dritan Gripshit, kartelë pasurie dhe harta treguese e regjistrimit.

vitit. Subjekti deklaron se nuk ka qenë i qartë në deklarimin e vitit 2008 në ILDKPKI, por në deklaratën *Vetting* gjatë hetimit administrativ dhe nga leximi i DPV-vjetore kursimet e vitit 2005 janë përdorur për blerjen e pasurisë tokë arë. Edhe po të vëresh burimin e krijimit të deklaruar në deklaratën *Vetting* rezulton se burimi i krijimit është huaja dhe kursimet nga pagat. Meqenëse likuiditeti në banka nuk është zvogëluar, burimi i krijimit të kësaj pasurie është huaja + kursimet nga pagat e vitit 2005 në vlerën 800.000 lekë. Pra, edhe aritmetikisht rezulton se "*Likuiditetet kursime të vitit 2005*⁴⁰" kanë shërbyer në fund të këtij vitit për blerjen e pasurisë tokë arë, me sipërfaqe 450 m². Edhe nga leximi i DPV-ve vjetore, i rubrikës së detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, rezulton qartësisht se huaja në shumën 1.200.000 lekë është destinuar për pagesën e blerjes së tokës dhe nga një logjikë e thjeshtë ekonomike rezulton që kursimet nga pagat e vitit në shumën 800.000 lekë kanë shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie në fund të vitit. Pra, DPV-të e viteve 2005 dhe 2007, deklarata *Vetting* dhe deklarimet gjatë hetimit administrativ janë në unitet me njëri - tjetrin. Subjekti shpjegon se ka qenë i paqartë në deklaratën e dhënë në ILDKPKI, në vitin 2008, por fakt është se gjendja *cash* në fund të vitit 2007 duhet lexohet sipas deklaratës së tij të këtij viti në shumën totale 3.050.000 lekë me burim 2.450.000 lekë nga shitja e apartamentit dhe 600.000 lekë kursime nga pagat. Kjo është edhe gjendja totale e disponuar *cash* në fund të këtij viti.

35.11 Subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit se në jurisprudencën e Kolegjit është konsoliduar qëndrimi se kontrolli i pasurisë fillon nga deklarata *Vetting* dhe meqenëse si burim për blerjen e pasurisë në deklaratë janë deklaruar kursimet nga pagat + huaja, në analizën financiare kursimet nga pagat në fund të vitit janë përdorur si burim për blerjen e pasurisë tokë arë.

35.12 Si konkluzion, subjekti ka argumentuar se analiza financiare për blerjen e tokës dhe e gjithë vitit 2005, nëse do të llogaritej sipas pretendimeve të paraqitura prej tij do të pasqyrohej me një balancë negative në shumën -186.053 lekë, diferencë e cila bazuar në parimet e proporcionalitetit dhe objektivitetit nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore.

35.13 Në vijim të analizës financiare dhe për të justifikuar burimet e tij të ligjshme, subjekti ka referuar se gjatë vitit 2004 ka pasur në ndjekje një dosje me shkallë vështirësie të lartë dhe, për këtë shkak, në vitin 2005 ka marrë edhe një shpërblim nga institucioni i Prokurorisë. Subjekti shpjegon se është përpjekur të gjejë dokumentacion në Prokurorinë e Përgjithshme dhe atë të Elbasanit, por nuk ka mundur të dokumentojë zyrtarisht përfitimin e këtyre shumave, për shkak se në këtë kohë nuk ka qenë e konsoliduar marrja e pagës ndërmjet sistemit bankar. Në kujtesë të subjektit, llogaritë bankare në atë kohë janë hapur nga mesi i vitit 2005, për këtë shkak këto të ardhura nuk evidentohen me ndonjë transfertë bankare.

35.14 Për sa më sipër, subjekti ka pretenduar se nëse Komisioni do të pranojë shpjegimet e tij, në përfundim do të rezultonte se ka disponuar mjaftueshëm burime të ligjshme financiare në vitin 2005 për të blerë tokën me sip. 450 m², në Sauk.

⁴⁰ Shënuar në këtë formë në DPV-në e vitit 2005.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me pasurinë tokë arë

36. Nga analiza mbi mundësinë e subjektit për të blerë me burime të ligjshme tokën arë, në Sauk, në vlerësim përfundimtar të akteve të administruara dhe pretendimeve të ngritura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, vëren se:

36.1 Për sa i përket të ardhurave të ligjshme të huadhënësit S.V, subjekti ka depozituar akte shtesë me të cilat provohet se: huadhënësi ka ushtruar aktivitet të ligjshëm dhe ka qenë i regjistruar si biznes i vogël/person fizik; ka provuar xhiron e realizuar, si dhe të ardhurat e përfituara nga shërbimet e ofruara prej tij, pranë shoqërisë “K.I” sh.a. Në lidhje me këto pretendime, Komisioni, pasi vlerësoi këtë dokumentacion referuar legjislacionit të kohës së ushtrimit të aktivitetit⁴¹, lidhur me xhiron e realizuar deri në shumën 2 milionë lekë, ka përllogaritur një marzh fitimi në masën 30% të xhiros. Nga kjo analizë, për periudhën 2004 – 2005 huadhënësi duhet të kishte përfituar një fitim neto jo më shumë se 1.200.000 lekë.

36.2 Gjithashtu, në prapësime subjekti pretendoi se familja V kishte në pronësi tokë bujqësore dhe ka kultivuar produkte bujqësore dhe ka realizuar të ardhura në vite. Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në prapësime, Komisioni ka vlerësuar të përllogarisë për bashkëshorten e shtetasit S.V një pagë minimale si e vetëpunësuar në bujqësi, për këtë periudhë. Duke reflektuar në analizë këtë të ardhur, analiza e kryer mbi mundësitë e huadhënësit, rezultoi me një balancë negative në shumën 368.139 lekë. Në këtë situatë, Komisioni nuk mori në konsideratë huan, si burim të ligjshëm.

36.3 Në lidhje me pretendimin e subjektit se gjendja *cash*, e deklaruar në DPV-në e vitit 2005, është përdorur për blerjen e truallit dhe nuk është disponuar prej tij si gjendje *cash* në datën 31.12.2005, Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit në DPV-në e vitit 2005 ka pasqyruar gjendjen faktike të situatës në datën 31.12.2005 e, për rrjedhojë, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, deklarimi i interesave privatë dhe pasurorë të paraqitura më parë, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit dhe ky pretendim nuk u pranua.

36.4 Në lidhje me pretendimin e subjektit se në analizën financiare të kryer nga Komisioni shpenzimet e trajtimit mjekësor të vajzës janë paguar në vitin 2006, Komisioni reflektoi në analizë ndryshimin përkatës në shumën 137.858 lekë.

36.5 Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën financiare për vitin 2005 duhet të hiqen shpenzimet e udhëtimit në Turqi, pasi subjekti me familjen kanë qëndruar në banesën e shtetasit A.G, konfirmuar ky fakt nga deklaratat noteriale⁴² e lëshuar nga ky shtetas. Komisioni e gjen këtë pretendim të pajustificuar me dokument shkresor, pasi nuk u arrit të provohet në ndonjë formë rezidenca e kushëririt të subjektit në Turqi, në përputhje me praktikat e tjera të ngjashme. Për këtë arsye, ky pretendim i subjektit nuk u pranua e, për pasojë, në analizën financiare nuk u reflektua ulja e pretenduar e shpenzimeve në zërin “Shpenzime udhëtimi”.

⁴¹ Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, aktualisht i shfuqizuar.

⁴² Nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.3.2024.

36.6 Pas prapësimeve, Komisioni rikreu analizën financiare të subjektit duke vlerësuar sa më sipër, e cila rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2.336.019 lekë, për vitin 2005.

36.7 Përfundimisht, në lidhje me pasurinë “truall” të ndodhur në Sauk, Tiranë, nuk u provuan burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

37. Shtëpi banimi dy kate + garazh, në Sauk, Tiranë, e ndërtuar mbi tokën arë me sip. 450 m². Vlera e deklaruar nga subjekti për ndërtimin e shtëpisë rreth 5.000.000 lekë, zotëruar nga subjekti 100%.

37.1 Subjekti ka deklaruar si burimi krijimi: kursimet e familjare dhe të ardhurat nga shitja e apartamentit në qytetin e Elbasanit datë 16.11.2007, me kontratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol.

Hetimi i Komisionit

38. Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, sektori i legalizimeve⁴³, ka konfirmuar se shtetasi Dritan Gripshi figuron si vetëdeklarues pranë Njësisë Vendore nr. **, me aplikimin nr. *** prot., datë 14.11.2006.

38.1 Subjekti, në përgjigje të pyetësorit⁴⁴, ka depozituar kartelën e pasurisë me përshkrimin: “Akti i fitimit të pronësisë: leje legalizimi nr. *** , datë: 7.8.2023. Objekt banimi 2 kate me sipërfaqe ndërtimi të katit përdhe 148.6 m² dhe sip. verande + shkalle 12.4 m², sip. ndërtimi e katit të parë 107 m² dhe sip. verande 10.1 m²”.

Analiza e fakteve dhe ndërtimi i shtëpisë

39. Subjekti, në tokën me sip. 450 m², blerë në datën 24.12.2005, ka deklaruar se ka ndërtuar një shtëpi me 2 kate, me sip. 244 m². Nga aktet e dosjes rezulton një formular “Vetëdeklarim për legalizimin e objektit”, me nr. *** prot., datë 14.11.2006, për legalizimin e objektit “shtëpi banimi”, në Sauk, Tiranë. Viti i ndërtimit 2006, sip. e zënë 450 m², sip. ndërtimi 244 m². Numri i kateve mbi tokë 2 (dy). Garazh me sip. 20 m².

39.1 Në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: “*Shtesë shtëpi banimi karabina, 2 kate sipërfaqja 248 m² e garazh 30 m², adresa Sauk, Tiranë, krijuar në vitin 2006, e paregjistruar në hipotekë*”.

39.2 Në lidhje me periudhën e ndërtimit të shtëpisë 2 kate, nga hetimi i Komisionit ka rezultuar se:

- Subjekti ka vetëdeklaruar në ALUIZN, shtëpinë me dy kate në datën 14.11.2006.
- Në DPV-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar: “*Shtesë shtëpi banimi karabina, 2 kate sipërfaqja 248 m² e garazh 30 m², në adresën Sauk, Tiranë, krijuar në vitin 2006, e paregjistruar në hipotekë në vlerën 2.950.000 lekë*”.
- Në DPV-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shpenzime ndërtimi 800.000 lekë.
- Në DPV-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar shpenzime ndërtimi 500.000 lekë.

⁴³ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2023.

⁴⁴ Ardhur me *email*-in datë 20.9.2023.

39.3 Në lidhje me periudhën e ndërtimit të shtëpisë 2 kate, subjekti ka shpjeguar⁴⁵ se: *“Shtëpia e banimit ka filluar të ndërtohet në vitin 2006 dhe pjesa më e madhe është ndërtuar gjatë këtij viti, por punime të brendshme kanë vazhduar të kryhen edhe në vitet 2007 dhe 2008 (sipas shumave të deklaruara prej meje). Ndonjë punim shtesë rifiniture është kryer edhe në vazhdim, vit pas viti, por në vlera të vogla”.*

Kostoja totale e ndërtimit të shtëpisë

40. Në lidhje me koston e ndërtimit subjekti ka shpjeguar se: *“Ndërtesa është kryer në mënyrë informale dhe pjesa më e madhe e së cilës është ndërtuar gjatë vitit 2006. Unë kam deklaruar shpenzimet e kryera në vitin 2006 në vlerën 2.950.000 lekë, në vitin 2007 në vlerën 800.000 lekë dhe disa punime të brendshme gjatë vitit 2008 në shumën 500.000 lekë sipas shpenzimeve të kryera realisht dhe shënimeve të mbajtura në këto vite. Në vitin 2008, banesa ka qenë e përfunduar dhe mund të jenë kryer ndonjë rinovim apo punim i vogël gjatë viteve, po në vlera të vogla të cilat nuk kanë qenë objekt deklarimi.*

Në deklaratën Vetting kam deklaruar rreth 5.000.000 lekë duke iu referuar një përlllogaritjeje të përafërt bazuar në koston e ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, por duke zbritur një përqindje, që në vlerësimin tim përbënin shumën e shpenzimeve që nuk kryhen në ndërtimet informale”.

40.1 Në kushtet kur subjekti nuk ka depozituar dokumentacion provues (situacion, fatura, preventiv, etj.) për shpenzimet e kryera në kohën e ndërtimit të shtëpisë prej tij apo familjarëve të tij, Komisioni arsyetoi se për një qëndrim objektiv, si dhe referuar praktikave të mbajtura në raste analoge, kostoja e ndërtimit do të llogaritet duke marrë si referencë çmimet e EKB-së, sipas publikimeve në faqen zyrtare të saj për vitin 2006⁴⁶. Sipas udhëzimit për vitin 2006, çmimi mesatar për ndërtim të apartamenteve ka rezultuar 25.262 lekë/m².

40.2 Referuar kartelës së pasurisë, lëshuar më 18.9.2023, ka rezultuar se sipërfaqja totale e ndërtimit është 268 m² shtëpi dy kate. Sipas përlllogaritjes me çmimet e referencën sipas Entit Kombëtar të Banesave, vlera totale e investimit rezulton të jetë në shumën 6.770.216 lekë.

40.3 Për sipërfaqen e garazhit të mbyllur, Komisioni përlllogariti çmimin sipas EKB-së në masën 70%, duke qenë se është garazh i mbyllur. Vlera e përlllogaritur rezulton të jetë 353.668 lekë.

40.4 Në përfundim, referuar çmimeve të EKB-së, vlera totale e investimit për shtëpinë 2 kate rezultoi në shumën 7.1 milionë lekë, shumë e cila është përlllogaritur në analizën financiare për këtë pasuri.

Burimi i krijimit

41. Subjekti në deklaratën Vetting ka deklaruar si burim:
- të ardhurat nga kursimet;
 - të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan, datë 16.11.2007, në shumën 5.9 milionë lekë.

⁴⁵ Në përgjigje të pyetësorit ardhur me email-in datë 20.9.2023.

⁴⁶ https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2015/07/udhzim_5_07.09.pdf

41.1 Në përgjigjet e pyetësorit⁴⁷ subjekti ka shpjeguar se: “Burimi i krijimit për ndërtimin e banesës në vitin 2006 janë: kursimet e depozituara në Alpha Bank në llogarinë me nr. ***, në emër të bashkëshortes sime me sa mbaj mend në vitin 2002. Vlera e akumuluar në këtë llogari në vitin 2003 në shumën 3.158.000 lekë ka kaluar në llogarinë e përbashkët time dhe të bashkëshortes e krijuar në vitin 2003. Më pas, shuma e akumuluar në llogarinë e përbashkët është transferuar në datën 18.3.2004 në llogarinë e vjehrrit tim (për shkak të aplikimit të tij në ambasadën amerikane), i cili e ka tërhequr shumën e kaluar në llogarinë e tij (së bashku me interesat e krijuar) dhe na e ka kthyer në janar të vitit 2006 shumën e tërhequr në vlerën totale 3,540,000 lekë.

Gjithashtu, në vitin 2003 është krijuar edhe një llogari e përbashkët në emrin tim, të bashkëshortes dhe vajzës M, me vlerë fillestare 1.000.000 lekë. Kjo është investuar në depozita kursimi, duke përfutur interesa dhe gjatë vitit 2006 nga kjo depozitë nga ana ime është tërhequr shuma 682.000 +250.000 lekë = 932.000 lekë, të cilat kanë shërbyer si burim për shpenzimet e kryera gjatë vitit 2006 për ndërtimin e banesës dhe shpenzime të tjera të vitit”.

41.2 Për sa më sipër, Komisioni konstatoi se:

- Nuk përputhen deklaratimet e subjektit në deklaratën *Vetting* me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit për burimin e krijimit të pasurisë ndërtesë 2 kate. Nga verifikimi i të dhënave bankare u konstatua se dy depozitat e çelura në Alpha Bank nga viti 2001 e në vijim, subjekti i ka tërhequr në vitin 2006, pa deklaruar destinacionin e tyre në deklarin periodik vjetor, si dhe nuk rezultojn t'i ketë përdorur si burim për ndonjë investim tjetër.

Analiza financiare

42. Komisioni ka analizuar burimet e deklaruara në *Vetting*, për ndërtimin të banesës 2 kate, në vijim:

- të ardhurat nga kursimet;
- të ardhurat nga shitja e apartamentit në Elbasan, datë 16.11.2007, në shumën 5.9 milionë lekë.

42.1 Subjekti ka deklaruar se kursimet familjare janë shumat e depozituara në Alpha Bank.

42.2 Komisioni ka kryer një analizë financiare në lidhje me mundësinë për krijimin e dy depozitave të çelura në Alpha Bank, me burime të ligjshme.

43. Depozita në shumën 3.000.000 lekë, çelur në vitin 2001, në emër të shtetasve E dhe Dritan Gripshi

43.1 Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit dhe familjarëve të tij në Alpha Bank (tashmë OTP Bank) u evidentua një depozitë e çelur në vitin 2001. Në datën 25.1.2001 janë depozituar 2.500.000 lekë *cash* në llogarinë e shtetasve E dhe Dritan Gripshi. Në këtë llogari janë shtuar edhe rreth 405.000 lekë, derdhur *cash*, në korrik të vitit 2001 dhe rreth 95.000 lekë nga interesat bankarë. Në fund të vitit 2001, depozita rezultojn me një gjendje totale 3.000.000 lekë.

⁴⁷ Ardhur me *email*-in e datës 20.9.2023.

43.2 Nga verifikimi i deklaratës së parë periodike të subjektit, asaj të vitit 2003, si dhe të deklaratimeve periodike vijuese konstatohet se:

- Subjekti nuk ka deklaruar depozitën në emër të bashkëshortes në Alpha Bank e, më pas, transferimin e saj në llogari dyemërore.

43.3 Nga verifikimi i llogarisë rezulton se deri në vitin 2004 fondet kanë qenë në depozitë në emër të znj. E.G. Në datën 5.8.2003, këto fonde janë transferuar në llogarinë dyemërore në emër të saj dhe subjektit në të njëjtën bankë, e cila ishte në shumën 3.158.000 lekë, me përshkrimin “Transferuar me urdhër të E.G në llogarinë me dy emra”.

43.4 Në datën 18.3.2004⁴⁸, fondet e akumuluar dhe interesat në shumën 3.271.123 lekë janë transferuar në llogarinë e shtetasit B.I (vjehtërit të subjektit) me përshkrimin “Kalim nga llogaria në llogari me kërkesë të vetë klientit”. Në datën 20.1.2006, babai i bashkëshortes ka tërhequr *cash* shumën 3.540.700 lekë, me përshkrimin në statement “Prishje e depozitës para afatit”.

43.5 Referuar informacionit të administruar në dosje, Komisioni kreu një analizë financiare mbi mundësinë e krijimit të depozitës në shumën 3.000.000 lekë, me burime të ligjshme për periudhën 1995 – korrik 2001.

43.6 Nga analiza financiare e kryer lidhur me mundësitë për krijimin e depozitës në vitin 2001 rezultoi një balancë negative në shumën 1.598.762 lekë.

44. Depozita në shumën 1.000.000 lekë, çelur në vitin 2003, në emër të shtetasve M, E dhe Dritan Gripshi

44.1 Nga verifikimi i llogarive bankare të subjektit dhe familjarëve të tij në Alpha Bank (tashmë OTP Bank) u evidentua historiku i një depozitë të çelur në vitin 2003. Në datën 15.9.2003 janë depozituar 1.000.000 lekë *cash* në llogarinë e shtetasve M, E dhe Dritan Gripshi dhe ka qëndruar si depozitë duke akumuluar interesa në vite dhe është tërhequr pjesërisht më 18.10.2006 – shuma 1.182.923 lekë dhe më 26.12.2008 – shuma 276.000 lekë.

44.2 Referuar informacionit të administruar në dosje, Komisioni kreu një analizë financiare mbi mundësinë e krijimit të depozitës në shumën 1.000.000 lekë, me burime të ligjshme për periudhën 1.8.2001 – 15.9.2003.

44.3 Nga analiza financiare e Komisionit rezultoi një balancë negative në shumën 387.860 lekë për krijimin e depozitës në vitin 2003.

45. Në lidhje me burimin e krijimit – kursime nga pagat në vite

45.1 Komisioni kreu një analizë financiare për periudhën 2006 – 2008.

45.2 Nga analiza financiare e kryer për periudhën kur është kryer ndërtimi, për vitin 2006, periudha në të cilën është ndërtuar shtëpia private, subjekti ka rezultuar me një balancë negative në shumën 900.568 lekë.

46. Konstatime të Komisionit

46.1 Për pasurinë ndërtesë 2 kate, në Sauk, rezultoi se:

⁴⁸ Subjekti ka pretenduar se këto fonde u transferuan me qëllim pajisjen e vjehtërit me vizë amerikane dhe në mbështetje të këtyre shpjegimeve ka depozituar vizën amerikane të shtetasve B dhe Z.I të vlefshme për periudhën 27.5.2005 – 26.11.2005.

- ✓ Nuk përputhen deklaramet e subjektit në lidhje me burimin e krijimit të ndërtesës 2 kate.
- ✓ Subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë 2 kate në shumën totale 2.887.190 lekë, e detajuar si më poshtë:
 - Nga analiza financiare e kryer për krijimin e depozitës pranë Alpha Bank në vitin 2001, e përdorur si burim për ndërtimin e shtëpisë subjekti dhe bashkëshortja paraqiten me një balancë negative në shumën 1.598.762 lekë.
 - Nga analiza financiare e kryer për krijimin e depozitës pranë Alpha Bank në vitin 2003, e përdorur si burim për ndërtimin e shtëpisë, subjekti dhe bashkëshortja rezultuan me balancë negative në shumën 387.860 lekë.
 - Nga analiza financiare e vitit 2006, për kursimet e subjektit e bashkëshortes, të cilat janë investuar në ndërtimin e shtëpisë, rezultoi një balancë negative në shumën 900.568 lekë.
- ✓ Subjekti nuk ka deklaruar depozitën në emër të bashkëshortes, e çelur në Alpha Bank, në deklaramin e tij të parë në vitin 2003 e në vijim.

46.2 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

47. Në lidhje me shtëpinë e banimit 2 kate, ndërtuar në mënyrë informale, subjekti ka pretenduar sa vijon:

47.1 Në lidhje me burimin e krijimit të shtëpisë 2 kate, subjekti ka shpjeguar se në deklaramin *Vetting* ka deklaruar saktë burimin e krijimit të kësaj pasurie, të cilat janë kursimet familjare dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në qytetin e Elbasanit në datën 16.11.2007. Në deklaramin periodike vjetore të vitit 2006, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit, por duke qenë se në deklaramin *Vetting* ka deklaruar saktë burimin e krijimit, e cila përputhet dhe me veprimet bankare dhe juridike të kryera në këto vite, subjekti pretendon se pasaktësia e mosdeklaramit të burimit të krijimit së kësaj ndërtese është e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit.

47.2 Në lidhje me koston e ndërtimit të shtëpisë, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim me deklaramin e dhëna gjatë hetimit administrativ, ku ka shpjeguar se ndërtesa është kryer në mënyrë informale dhe pjesa më e madhe e së cilës është ndërtuar gjatë vitit 2006⁴⁹. Në deklaramin *Vetting*, subjekti ka deklaruar se ndërtimi ka kushtuar rreth 5.000.000 lekë duke iu referuar një përlllogaritjeje të përafërt, bazuar në koston e ndërtimit të Entit Kombëtar të Banesave, por duke zbritur një përqindje, që në vlerësimin tij përbënin shumën e shpenzimeve që nuk kryhen në ndërtimet informale.

47.3 Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka depozituar një raport vlerësimi⁵⁰ (aktin e ekspertimit) për koston e ndërtimit të shtëpisë në Sauk, hartuar nga një ekspert i licencuar si

⁴⁹ Subjekti ka deklaruar shpenzimet e kryera në vitet 2006 në vlerën 2.950.000 lekë, në vitin 2007 në vlerën 800.000 lekë dhe disa punime të brendshme gjatë vitit 2008 në shumën 500.000 lekë sipas shpenzimeve të kryera realisht dhe shënimeve të mbajtura në këto vite. Në vitin 2008, banesa ka qenë e përfunduar dhe në vijim (pas vitit 2008) janë kryer rinovime apo punimeve të vogla, në vlera të cilat nuk kanë qenë objekt deklarimi.

⁵⁰ I datës 20.9.2023.

vlerësues pasurish të paluajtshme, i cili u administrua nga Komisioni në cilësinë e provës. Për koston e ndërtimit të shtëpisë çmimi mesatar për ndërtim të apartamenteve referuar udhëzimi të Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2006, ka rezultuar 25.262 lekë/m². Subjekti ka pretenduar se ndërtesa është informale dhe nga ky çmim, ashtu siç ka përshkruar edhe eksperti në aktin e ekspertimit kontabël dhe ekspertimin teknik, duhet të zbriten disa zëra të koston së ndërtimit, të cilat nuk përfshihen në ndërtimet informale. Subjekti shpjegon se edhe në praktikën e konsoliduar të Kolegjit, përlllogaritjet kryhen duke zvogëluar koston e ndërtimit me zërat që nuk përfshihen në koston e ndërtimit. Subjekti ka pretenduar se në zbatim të jurisprudencës së Kolegjit, Komisioni duhet të kishte zbritur nga këto kosto, ta paktën vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar. Referuar raportit të vlerësimit të pasurisë, hartuar nga vlerësuesi i pasurive të paluajtshme, vlera totale e shtëpisë është llogaritur prej tij, sipas koston mesatare të EKB-së për vitin 2006, në shumën 4.842.725 lekë.

47.4 Subjekti shpjegon se referuar kartelës së pasurisë, lëshuar më 18.9.2023, ka rezultuar se sipërfaqja totale e ndërtimit është 278⁵¹m² shtëpi dy kate, përfshirë garazhin dhe verandën. Nga planimetria e banesës rezulton se vlera e shtëpisë pa garazhin dhe verandën është 235,5 m² ndërsa veranda dhe garazhi janë në masën 42,5 m². Bazuar në jurisprudencën e Kolegjit edhe sipërfaqja e verandës përlllogaritet në 50% të koston, ndërsa ajo e garazhit duhet të përlllogaritet në masën 70% të koston së ndërtimit. Për këtë arsye, Komisioni në llogaritjen e koston së ndërtimit duhet t'i referohej sipërfaqes së pasurisë sipas planimetrisë.

47.5 Subjekti, në prapësime të rezultateve të hetimit, ka depozituar një raport analize financiare, të hartuar nga një auditues ligjor privat ku, ndër të tjera, ka vlerësuar edhe mundësinë e familjes së subjektit për të ndërtuar shtëpinë 2 kate me burime të ligjshme. Bazuar në analizën financiare të kryer nga eksperti kontabël, sipas përlllogaritjes me çmimet e referencës së EKB-së, por duke reduktuar koston⁵² sipas analizimit të ekspertit, bazuar edhe

⁵¹ Ka lapsur në përlllogaritjen e Komisionit që duhet të korrigjohen.

⁵² Në aktin e ekspertimit eksperti ka analizuar ndër të tjera: "Referuar këtyre deklarimeve rezulton se ndërtimi i shtëpisë ka kushtuar mesatarisht 4.25 milion lekë, ndërkohë që në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar se ndërtimi i shtëpisë ka kushtuar rreth 5 milion lekë. Bazuar në këto vetëdeklarimet të subjektit, rezulton se pesha specifike e ndërtimit gjatë vitit 2006 është 69.41% (2.950.000/4.250.000). Gjatë vitit 2007 është kryer 18.82% e ndërtimit (800.000/4.250.000) dhe gjatë vitit 2007 është kryer 11.76% e ndërtimit (500.000/4.250.000).

Nëse i referohemi peshës specifike të fazave të ndërtimit sipas vetëdeklarimeve të subjektit, shpërndarja e koston së ndërtimit bazuar në çmimet e EKB-së, sipas publikimeve në faqen zyrtare të saj për vitin 2006, do të ishte:

Sipas udhëzimit për vitin 2006, çmimi mesatar për ndërtim të apartamenteve ka rezultuar 25.262 lekë/m². Këtij çmimi duhet ti zbresim 10% për zërin "Fitim dhe fond rezervë", bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, "Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit".

Gjithashtu, për sipërfaqen e garazhit të mbyllur, përlllogarisim çmimin sipas EKB-së në masën 70%, duke qenë se është garazh i mbyllur dhe për verandat përlllogarisim çmimin sipas EKB-së në masën 50%.

Nga kostoja e ndërtimit duhet të bëhet zbritja sa i takon zërit "Fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë". Përveç këtij elementi, nga kostoja e ndërtimit duhen zbritur TVSH-ja e pagueshme dhe pjesa e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguhen nga punëdhënësi.

Për këtë arsye, marrëveshja ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka përcaktuar se 27.4% e TVSH-së së llogaritur do të konsiderohet si TVSH minimale e pagueshme.

Kjo shumë TVSH-je paguhet në rastet e shoqërive të ndërtimit por jo në rastet e ndërtimit për vete nga individë të cilët nuk janë regjistruar në organet tatimore. Formulari i vetëdeklarimit të ndërtimit informal tregon se ndërtimi është kryer jo me firmë ndërtimi, pasi në të kundërt do të disponohej në dosje preventivi, aktin e kolaudimit etj.

Në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e lidhur në datën 17.5.2006, përcaktohet se TVSH – ja që krijohet në procesin e ndërtimit (puna e gjallë, shpenzimet plotësuese, ngritja e kantierit, lidhja me rrjetin, etj) për 1 m² sipërfaqe ndërtimi apartament përfaqëson 27.4% të TVSH së llogaritur bazuar në çmimin e koston së ndërtimit në atë vit.

Duke pasur parasysh këtë marrëveshje, në përlllogaritjen e investimit të mësipërm për çdo vit, duhet zbritur nga çmimi dhe TVSH-ja e mbledhshme vlera prej 27.4%. Në rastin konkret kur ndërtimi është informal dhe është kryhet nga individë, nuk aplikohet TVSH.

në jurisprudencën e trupave gjykues të rivlerësimit, vlera totale e investimit, për ndërtimin e shtëpisë 2 kate rezultoi në shumën 5.970.830 lekë.

47.6 Me gjithë, përfundimin e arritur nga audituesi ligjor, subjekti ka shpjeguar se i qëndron deklaramëve të tij, se ndërtimi i shtëpisë 2 kate, ka kushtuar rreth 5.000.000 lekë, por duke pranuar logjikën dhe Jurisprudencën e Komisionit, vlerën e investimit që ka rezultuar i shpërndarë në vitet 2006 - 2008, duke ruajtur në raport të drejtë me vlerat e deklaruara prej tij, në deklaratat periodike vjetore në vitet 2006 - 2008. Shpenzimet për ndërtimin e banesës janë përkatësisht në vitin 2006, ka deklaruar rreth 69,4% të kostos totale të banesës, e cila aktualisht sipas logjikës së komisionit dhe bazuar në përlllogaritjet e sipërcituara, është në vlerën 3.765.172.9 lekë, në vitin 2007 – 18.82% në vlerën 1.021.063 lekë dhe në vitin 2008 -11,8% të kostos së banesës në vlerën 638.164,9 lekë.

47.7 Për sa i përket depozitës në shumën 3.000.000 lekë, çelur në vitin 2001, dhe konstatimit të Komisionit se kjo depozitë nuk është deklaruar nga subjekti në DPV-në e parë të pasurisë, ai ka shpjeguar se ky fakt, si dhe ligjshmëria e krijimit të saj është kontrolluar nga organet ligjzbatuese, vendimmarrje, e cila edhe për shkak edhe të parimit të sigurisë juridike, përbën gjë të gjykuar. Prokuroria ka analizuar në vitin 2006 ligjshmërinë e kësaj depozite dhe e ka gjetur me burime të ligjshme. Pra, në rastin konkret, pasaktësia e mosdeklarimit të kësaj pasurie e ndrequr jashtë procesit të rivlerësimit mbetet e karakterit formal dhe pa pasoja në procesin e rivlerësimit duke mbajtur parasysh edhe faktin se më poshtë do të argumentojmë mjaftueshmërinë financiare për krijimin e kësaj depozite.

47.8 Në lidhje me burimet e ligjshme të depozitës, çelur në vitin 2001, subjekti ka shpjeguar se gjatë hetimit administrativ ka depozituar pranë Komisionit një deklaratë noteriale, lëshuar nga shtetasi S.E, i cili ai ka deklaruar se: *“Në periudhën prill 1996 – janar 1997 ka qenë i punësuar pranë fondacionit bamirës “****”, me detyrë drejtor i filialit Peqin. Ky shtetas ka deklaruar se: Mandatet me nr. ***, datë 30.12.1996, në shumën 288.000 lekë, i cili ka si origjinë mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.9.1996, në shumën 90.000 lekë; me nr. ***, datë 30.12.1996, në shumën 288.000 lekë, i cili ka si origjinë mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.9.1996, në shumën 90.000 lekë; dhe nr. ***, datë 30.12/1996, në shumën 288.000 lekë, i cili ka si origjinë mandatarkëtimin nr. ***, datë 28.9.1996, në shumën 90.000 lekë; të tria mandatet janë plotësuar dhe nënshkruar prej tij, në cilësinë e drejtorit të filialit dhe të gjitha shumat në këto mandate janë depozituar në filialin e degës Peqin nga shtetasi Dritan Gripshi dhe janë tërhequr po prej tij në datën 30.12.1996 po nga Dritan Gripshi”.*

47.9 Subjekti shpjegon se nga analizimi i mandatit nr. ***, datë 30.12.1996, rezulton t’i jetë paguar shtetasve B.K (30), M.K (30) dhe Dritan Gripshi (30) shuma 288.000 lekë, si fitim për shumën e arkëtuar 90.000 lekë.

47.10 Referuar mandatit nr. ***, datë 30.12.1996, rezulton t’i jetë paguar shtetasve E.G (30), M.G (30) dhe N.G (30) shuma 288.000 lekë, si fitim për shumën e arkëtuar 90.000 lekë.

Në marrëveshje është përcaktuar edhe masa e kontributit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që paguan si shoqëria ashtu edhe punonjësi për 1 m² sipërfaqe ndërtimi apartament. Kontributi minimal i sigurimeve që duhet të paguajë shoqëria ndërtuese për 1 m² sipërfaqe ndërtimi apartament sipas EKB – së është 1,274 lekë (918 + 356 = 1,274 lekë). Bazuar në sipërfaqet e realizuara çdo vit Komisioni duhet të ndryshojë analizën financiare duke zbritur 1,274 lekë për çdo metër katror të ndërtuar.

47.11 Kurse mandati tjetër nr. ***, datë 30.12.1996, rezulton t'i jetë paguar shtetasve A.G (30), F.G (30) dhe një shtetasi tjetër (30) shuma 288.000 lekë, si fitim për shumën e arkëtuar 90.000 lekë.

47.12 Subjekti ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit duke mos përfshirë në analizë këto të ardhura, të cilat ai i pretendon se si depozitimet e tyre dhe tërheqjet sipas mandateve të sipërcituara, janë kryer të gjitha prej tij, por për shkak të rregullave të fondacionit janë vendosur emra të familjarëve apo miqve të tij.

47.13 Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar shkresën e lëshuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, me nr. ** prot., datë 4.3.2024, e cila i drejtohet subjektit, ku referohet se: *“Nga kontrolli i dokumentacionit të ndodhur në firmat piramidale, emri i subjektit nuk figuron në listat e kreditorëve aktualë të këtyre shoqërive, pasi ne nuk disponojmë lista të personave që kanë mbyllur kontratat e huas me shoqërinë “***”, para marrjes në administrim nga shteti shqiptar. Nga krahasimi i mandateve të paraqitur nga ana juaj me mandatat që administrohen nga ana jonë rezulton se këto mandate janë në formë dhe natyrë të njëjtte me mandatat që ndodhen në dosjet e kreditorëve këtyre shoqërive, të cilët nuk kishin mbyllur kontratat me shoqërinë “***” para marrjes në administrim nga shteti shqiptar. Gjithashtu, sipas kësaj shkrese, konfirmohet se z. S.E, i cili ka nënshkruar këto mandate si përfaqësues i shoqërisë “***” rezulton te ketë qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie me detyrën e drejtorit të filialit Peqin”.*

47.14 Subjekti, në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, ka argumentuar se për shkak se firmave piramidale nuk kishin mundësi për shlyer detyrimet që kishin ndaj qytetarëve kreditorë, lindi nevoja e ndërhyrjes së shtetit nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 8188, prot., datë 23.01.1997, “Për ndalimin e skemave piramidale mashtruese të huamarrjes” dhe vënies para përgjegjësisë ligjore të pronarëve të këtyre firmave për veprën penale “Mashtrimi” në përmasa të mëdha e më shumë se një herë. Në këto kushte, deri në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 8188, datë 23.01.1997, aktiviteti i firmave rentiere ka qenë i ligjshëm dhe, për rrjedhojë, edhe të ardhurat e përfituara prej tyre. Ky arsyetim vjen në përputhje qëndrimin e mbajtur për të ardhurat nga firmat piramidale edhe në vendimin nr. 15/2021.

47.15 Subjekti për efekt të analizës financiare ka kërkuar nga Komisioni:

- që shpenzimet jetike të familjes së tij të llogariten nga Komisioni në masën 30% të të ardhurave dhe jo sa janë llogaritur nga Komisioni, mbështetur kjo në vendimin nr. 15/2021 të Kolegjit;
- të përfshihet në analizë vlera e plotë e të ardhurave të përfituara nga firmat piramidale sipas 3 mandateve;
- të përfshihet në analizë shuma e plotë e përfituar nga shitja e banesës në Elbasan në vitin 1998, në shumën 700.000 lekë.

47.16 Në vijim të provave të depozituara nga subjekti, nga analiza e kryer edhe nga audituesi ligjor, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për efekt të analizës financiare si më sipër, rezulton vetëm balancë negative për krijimin e depozitës në vitin 2003, në shumën -58.678 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

48. Komisioni, pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti, vëren se:

48.1 Në lidhje me koston e ndërtimit të shtëpisë 2 kate, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor koston e objektit të ndërtuar në mënyrë informale, sipas jurisprudencës së konsoliduar tashmë të Kolegjit, kostoja do të përlogaritet duke iu referuar çmimeve të përcaktuara ndër vite prej Entit Kombëtar të Banesave, si një standard i arsyeshëm, në mungesë të çdo akti tjetër që provon një vlerë të ndryshme ndërtimi. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, jurisprudenca e Komisionit dhe e Kolegjit është bazuar në të dhënat zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave, për të vlerësuar koston e ndërtimit, duke e konsideruar vlerën e përlogaritur në këtë mënyrë si kosto që përafrohet me nivelin më të arsyeshëm dhe të besueshëm të koston reale të ndërtimit.

48.2 Trupi gjykues, referuar edhe praktikës së Kolegjit⁵³, vlerëson se nuk është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për zbritjen nga kostoja totale e ndërtimit e vlerës që zë përqindja e TVSH-së në këtë ndërtim, pasi ajo është paguar nga subjekti tregtar pranë të cilit ai i ka blerë materialet për ndërtimin e objektit, referuar nenit 1, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar: *“Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) paguhet: a. për të gjitha furnizimet e tatueshme të mallrave dhe shërbimeve të kryera kundrejt pagesës prej një personi të tatueshëm, si pjesë e veprimtarisë së tij ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë”*.

48.3 Trupi gjykues, për të garantuar një gjykim sa më të drejtë dhe të plotë, duke marrë në konsideratë në mënyrë hipotetike edhe pretendimin e subjektit për llogaritjen e koston së ndërtimit duke zbritur disa elemente të koston si fitimi i planifikuar dhe fondi rezervë nga kostoja e ndërtimit, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor kreu analizën financiare bazuar në manualet e preventivimit të punimeve të ndërtimit dhe formatit të analizës teknike të punimeve të ndërtimit, miratuar me udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, “Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit”, duke zbritur vlerat që i korrespondojnë fondit rezervë dhe fitimit të planifikuar në masën 9.39% për vitin 2006, ndërsa për vitet më pas nuk do të ndryshohet, pasi subjekti këto shpenzime i ka deklaruar si shpenzime koherente në DPV-të përkatëse. Në analizën financiare për vitin 2006, vlera e investimit rezulton në shumën 5.1 milionë lekë dhe vlera totale e investimit të shtëpisë 2 kate rezultoi në shumën afërsisht 6.4 milionë lekë.

48.4 Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga firmat piramidale, mbështetur edhe në vërtetimin nr. ** prot., datë 4.3.2024, lëshuar nga Shoqëritë Huamarrëse në Administrim, subjekti ka provuar se shtetasi S.E, i cili ka nënshkruar mandatpagesat nga fondacioni “****” ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie me detyrën e drejtorit të filialit Peqin. Për këtë arsye, Komisioni i mori në konsideratë dhe ka përfshirë në analizën financiare të tij shumën 132.000 lekë, e cila rezultoi në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

48.5 Në lidhje me pretendimin e subjektit se ai ka përfituar të gjitha shumat e cituara në 2 mandatet e tjera në shumën rreth 594.000, ku titullarët e cituar në këto mandate janë persona

⁵³ Vendimit nr. 59/2019 regjistër (JR), datë 17.3.2022.

të ndryshëm nga subjekti, për Komisionin këto shpjegime nuk janë bindëse dhe nuk pranohen për aq kohë sa mbetën të paprovuara nga subjekti.

48.6 Për efekt të analizës financiare Komisioni ka pranuar të llogarisë shpenzimet jetike të subjektit në masën 30% të të ardhurave për periudhën 1994 – 1999, si dhe ka përfshirë të plotë në analizë shumën 700.000 lekë, përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan në vitin 1998.

48.7 Pas prapësimeve, analiza financiare mbi mundësitë e subjektit për ndërtimin e shtëpisë 2 kate, rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme, në shumën 2.099.057 lekë.

48.8 Në lidhje me pasurinë “shtëpi banimi 2 kate”, të ndodhur në Sauk, Tiranë, subjekti nuk ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

- 49. Autoveturë tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 2002, blerë në vitin 2016, në shumën 2.100 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me burim kursimet nga pagat e tij dhe bashkëshortes ndër vite.**

Hetimi i Komisionit

50. DPSHTRR-ja⁵⁴ ka konfirmuar automjetin me targë AA *** NK, të regjistruar në DRSHTRR-në Berat, në pronësi të z. Dritan Gripshi.

Analiza financiare për automjetin

51. Subjekti në deklaratën para fillimit⁵⁵ të detyrës plotësuar në vitin 2015, si dhe në deklaratën periodike të vitit 2015, nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Për këtë shkak, nga Komisioni si burim për blerjen e automjetit janë llogaritur të ardhurat e krijuara gjatë vitit 2016. Komisioni kreu analizën financiare në datën e blerjes së automjetit, duke marrë në konsideratë të ardhurat shpenzimet dhe likuiditetet për periudhën janar - mars 2016, nga ku rezultoi me një balancë negative në shumën 96.563 lekë.

51.1 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

52. Subjekti ka shpjeguar se automjeti është blerë në shumën 2.100 euro dhe si burim për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes ndër vite. Subjekti ka pretenduar se konkluzioni i Komisionit nuk është i saktë dhe se përfundimi për mundësitë e subjektit për të blerë këtë automjet duhet të vlerësohet nën dritën e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit në kushtet kur dhe balancat pozitive në vitet 2011 – 2016 janë në vlera të konsiderueshme dhe balanca e vitit 2015 është në shumën 1.774.915 lekë, kjo referuar analizës së paraqitur subjektit.

Vlerësimi i Komisionit

53. Komisioni vlerëson se pretendimet e subjektit janë të papranueshme, pasi subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës, të plotësuar në vitin 2015, si dhe në deklaratën periodike

⁵⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021.

⁵⁵ Pasi është rikthyer në detyrë me vendimin nr. ***, datë 24.10.2014, të Gjykatës së Apelit Administrativ.

të vitit 2015, nuk ka deklaruar gjendje *cash* dhe, për këtë shkak, si burim për blerjen e automjetit janë llogaritur të ardhurat e krijuara gjatë vitit 2016.

53.1 Analiza financiare e subjektit paraqitet me gjendje negative në shumën rreth 33.000 lekë dhe përfundimisht u konkludua se subjekti nuk ka provuar burimet e ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 33 të ligjit nr. 84/2016.

54. Obligacione në shumën 3.000.000 lekë, të investuara në Intesa Sanpaolo Bank në emër të z. Dritan Gripshi, me burim shumën 2.800.000 lekë, përfituar në zbatim të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 24.10.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ndërsa pjesa tjetër 200.000⁵⁶ lekë është plotësuar nga kursimet nga pagat.

Hetimi i Komisionit

55. Intesa Sanpaolo Bank⁵⁷ ka konfirmuar se z. Dritan Gripshi është titullar i bonove të thesarit, në shumën 3.000.000 lekë.

55.1 Për sa më sipër:

- ✓ Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga Intesa Sanpaolo Bank.
- ✓ Subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kësaj pasuri, kjo pasi evidentohen kreditimet në llogarinë bankare në shumën 2.800.000 lekë, në datën 19.8.2015, nga Prokuroria e Rrethit Berat dhe ka pasur mundësi për krijimin e shumës shtesë 200.000 lekë në llogari.

Deklarim i pasurive të bashkëshortes së subjektit – E.G

56. Automjet tip “V.P”, vit prodhimi 2000, dhuruar në janar 2010, zotëruar 100% nga bashkëshortja e subjektit. Automjeti dhuruar bashkëshortes së subjektit nga shtetasja K.K. Automjet i shitur në datën 28.1.2017 për pjesë këmbimi në shumën 100.000 lekë.

Hetimi i Komisionit

57. DPSHTRR-ja⁵⁸ ka konfirmuar se shtetasja E.G ka pasur të regjistruar automjetin me targë TR *** T, të regjistruar në DRSHTRR Tiranë. Automjeti me targë TR *** T është nxjerrë nga qarkullimi në datën 21.3.2018. Për këtë automjet disponohet vlera e zhdoganimit të mjetit në shumën 128.890 lekë.

57.1 Nga hetimi i kryer nuk rezultojnë të dhëna mbi çmimin e blerjes së këtij automjeti nga znj. K.K, si dhe arsyen/shkakun e dhurimit të këtij automjeti nga kjo shtetase tek bashkëshortja e subjektit.

58. Konstatime të Komisionit për automjetin

- Nga hetimi i kryer nuk ka rezultuar e dokumentuar vlera e kësaj pasurie të dhuruar.
- Subjekti nuk ka provuar me dokumentacion burimin e ligjshëm të dhurueses në masën e dhurimit.

⁵⁶Subjekti në deklaratën *Vetting* ka deklaruar shumën 2.000.000 lekë, që duket të jetë një lapsus i tij në plotësimin e deklaratës.

⁵⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.8.2021.

⁵⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 29.7.2021.

58.1 Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar burimet e ligjshme të dhurueses, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

59. Në lidhje me automjetin e dhuruar, subjekti në prapësime ka shpjeguar se:

59.1 Ky automjet i është dhuruar bashkëshortes nga shtetasja K.H, mikeshë e saj në atë kohë dhe e dashura (në atë kohë) e djalit të tezes së bashkëshortes. Kontrata e dhurimit është akt zyrtar me fuqi të plotë provuese. Subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja e tij i ka humbur kontaktet me këtë shtetase (për shkak se djali i tezes nuk ka vazhduar lidhjen me të) dhe, për këtë arsye, subjekti ka pretenduar se është në pamundësi objektive për të dokumentuar të ardhurat e shtetases K.H.

59.2 Subjekti ka shpjeguar se Komisioni në këtë pikë duhet të mbajë në vlerësim vlerën e vogël të këtij automjeti. Mundësinë financiare të tij të konsiderueshme për ta blerë këtë automjet me të ardhura të ligjshme, pasi subjekti nuk ka pasur asnjë arsye për ta deklaruar si dhurim nëse nuk do ishte e tillë, duke pasur në konsideratë faktin se në fund të vitit 2009, gjendja *cash* e familjes së subjektit ka qenë në shumën 3.700.000 lekë, gjendje e cila nuk rezulton në vijim të jetë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie.

Vlerësimi i Komisionit

60. Komisioni në lidhje me automjetin e dhuruar bashkëshortes së subjektit arsyeton se megjithëse subjekti nuk provoi me ndonjë akt shkresor pretendimet e tij, Komisioni i pranoi shpjegimet e subjektit, duke mos e ngarkuar me përgjegjësi me pasoja, për vlerësimin tërësor të subjektit, duke marrë në konsideratë rrethanat vijuese:

- subjekti në vitin 2009 ka rezultuar me balancë pozitive për të blerë një automjet në parametrat e automjetit të dhuruar;
- ka kaluar një kohë e gjatë që nga marrja e kësaj dhurate në vitin 2009 dhe mund të jetë e vështirë vendosja në kontakt me dhuruesin e automjetit në mënyrë që të provohen pretendimet e subjektit;
- automjeti rezultonte se ishte prodhuar në vitin 2000 dhe në vitin 2018 është nxjerrë jashtë qarkullimit, pasi ka rezultuar i amortizuar dhe i shitur për pjesë këmbimi.

GJETJE TË TJERA

61. Apartament i shitur në vitin 2006

61.1 Nga hetimi i Komisionit është konstatuar se subjekti ka disponuar një apartament me sip. 49.8 m², në Elbasan, të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave. Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 shitjen e këtij apartamenti në shumën 700.000 lekë, ndërkohë që subjekti ka pretenduar se ky apartament është shitur me aktmarrëveshjen e datës 9.4.1998.

61.2 Sipas certifikatës së pronësisë të lëshuar në vitin 2001, apartamenti është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe prindërve të tij në vitin 2001 dhe, për këtë arsye, në analizën financiare janë përfshirë 1/3 e të ardhurave të përfituara nga kjo shitje.

61.3 Për sa më sipër rezultoi se:

- Subjekti nuk ka deklaruar bashkëpronësinë mbi pasurinë apartament⁵⁹ në vitin 2003 dhe as pjesën takuese në masën 1/3 e apartamentit.

61.4 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit iu kërkua të jepte shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

62. Subjekti ka shpjeguar se kjo pasuri është privatizuar prej tij për shkak të punës që kryente në qytetin e Elbasanit dhe meqenëse në vitin 1998 kishte filluar të banonte në banesën tjetër, trajtuar më sipër, kishte nevojë që të ardhurat e përfituara nga kjo banesë të shlyhenin vlerën e apartamentit të dakordësuar me shtetasin S.H. Prandaj të gjitha të ardhurat nga kjo shitje janë përfituar prej tij. Në mbështetje të këtij shpjegimi subjekti ka depozituar deklaratën noteriale⁶⁰ të lëshuar nga nëna e subjektit, e cila ka konfirmuar se vlera e shitjes së kësaj pasurie është përfituar e gjitha nga subjekti.

Vlerësimi i Komisioni

63. Komisioni, pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të depozituar nga subjekti ne prapësime, ka evidentuar se nëna e subjektit H.G rezulton se ka disponuar shtëpi banimi në Peqin⁶¹, ku ka kryer edhe një shtesë, për të cilën ka aplikuar për të legalizuar në vitin 2006. Komisioni ka përfshirë në analizën financiare shumën e plotë të përfituar nga shitja e apartamentit në Elbasan në shumën 700.000 lekë, pasi mori në konsideratë rrethanat familjare të tij.

64. Dhurim nga Sh.G⁶² në vitin 2006

64.1 Subjekti ka deklaruar dhurim në shumën 3.000 euro, në DPV-në e vitit 2006, nga djali i xhaxhait të tij, shtetasi Sh.G. Subjekti ka depozituar dokumentacion provues për të ardhura të ligjshme⁶³ të realizuara nga shtetasi Sh.G si administrator i subjektit “I-S” sh.p.k., sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 21.12.2023, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan⁶⁴.

64.2 Subjekti ka depozituar kopje të listëpagesave për shtetasin Sh.G, ku duket se ky i fundit ka qenë i punësuar në shoqërinë “I-S” sh.p.k., me pronar shtetasin G.G. Nga certifikata familjare e shtetasit Sh.G rezulton se është i martuar dhe se ka një fëmijë të lindur në gusht 2006. Nuk është e qartë nëse ai ka qenë i martuar para dhënies së dhuratës. Nga verifikimi i dokumentacionit, duket se të ardhurat për dhuruesin i përkasin periudhës 2005 – 2011.

64.3 Referuar këtyre të dhënave, Komisioni analizoi të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën 2005 – 2006, nga ku rezultoi se dhuruesi nuk justifikon me burime të ligjshme dhënien e dhuratës në shumën 3.000 euro, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 830.957 lekë.

Konstatime të Komisionit

⁵⁹ Përfituar nga Enti i Banesave.

⁶⁰ Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2023.

⁶¹ Referuar ASHK-së Elbasan me nr. *** prot., datë 27.6.2023.

⁶² Djali i xhaxhait të subjektit.

⁶³ Ardhur me *email*-in e datës 13.11.2023 dhe me *email*-in e datës 22.12.2023.

⁶⁴ Bashkëlidhur të cilës janë:

- tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2003;
- deklarata analitike për tatimin mbi të ardhurat për vitin 2004, fitimi i tatueshëm për vitin 2004;
- formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin për vitin 2005, rezultati tatimor;
- formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit mbi fitimin për vitin 2006, rezultati tatimor.

65. Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, rezultoi se:

- Dhuruesi nuk justifikon me burime të ligjshme dhënien e dhuratës në shumën 3.000 euro, duke rezultuar me një balancë negative në shumën 830.957 lekë. Kjo shumë nuk është reflektuar në analizën financiare të subjektit për vitin 2006 si e ardhur e ligjshme.
- Ngrihen dyshime për veprime fiktive të subjektit me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme, të cilat subjekti i përdor në vitet në vijim për investime.

65.1 Në lidhje me këtë konstatim të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar burimet e ligjshme të dhuruesit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

66. Subjekti për dhuratën e shtetasit Sh.G, në shumën 3.000 euro, ka shpjeguar se:

66.1 Si burim për këtë shumë kanë shërbyer të ardhurat nga paga e tij dhe të ardhurat e realizuara nga kultivimi i tokës bujqësore. Për këto të ardhura ka depozituar edhe një akt ekspertimi, në të cilin janë përlogaritur të ardhurat nga aktiviteti bujqësor në periudhën 1994 – 2004.

66.2 Subjekti ka shpjeguar se shtetasi Sh.G ka përfituar tokë bujqësore me ligjin nr. 7501/1991 dhe referuar AMTP-së nr. ***, toka e përfituar nga shtetasi Sh.G është e ndarë në tokë arë me sip. 2.000 m²; pemëtoje 600 m²; ullishtë 2.000 m². Bazuar në përlogaritjen e kryer nga eksperti për të ardhurat nga toka bujqësore, rezulton se të ardhurat neto janë mbi 300.000 lekë.

66.3 Në vijim të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar një vërtetim (për të vetëpunësuar në bujqësi), lëshuar nga ISSH, dega rajonale Peqin, i vitit 2024 (data e palexueshme), me të cilin provohet se shtetasi Sh.G.G, banor në Peqin, ka tokë në përdorim dhe që nga viti 1994 figuron si i vetëpunësuar në bujqësi me nr. ***.

66.4 Subjekti ka shpjeguar se kontributet e derdhura sipas viteve janë për periudhën 1999 – 2004 dhe në bazë të ligjit, kusht për të derdhur sigurimin është zhvillimi realisht i aktivitetit bujqësor (referuar VKM-së Nr. 73, datë 30.1.1998, nr. 112, datë 18.3.1999 (i ndryshuar), nr. 402, datë 11.6.2001). Aktiviteti i fermerit dhe i të ardhurave të realizuara nga toka bujqësore në vitet 2000 – 2004 nuk ka qenë i rregulluar nga legjislacioni tatimor. Me udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” është rregulluar dhe normuar detyrimi për regjistrimin dhe pajisjen e fermerit me NIPT. Subjekti ka pretenduar se bazuar në të ardhurat nga toka bujqësore, bazuar edhe në raportin e audituesit ligjor, rezulton se shtetasi Sh.G ka pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të dhurojë shumën 3.000 euro.

66.5 Në këtë pikë, Komisioni duhet të mbajë në vlerësim edhe qëndrimin e Kolegjit për dhurimet e kryera nga familjarët, të cilat kanë një peshë specifike të vogël. Kështu, në vendimin nr. 15/2021, Kolegji ka konkluduar se: *“24.3 Kolegji e analizoi këtë çështje edhe në drejtim të mundësisë së vëllait të subjektit për ta dhënë këtë shumë si dhuratë. Në këtë kontekst, Kolegji mban në konsideratë se ashtu siç edhe subjekti ka deklaruar për vëllain e tij ka qenë e pamundur të jetonte në Itali vetëm me këto të ardhura të deklaruara e të tatuara për të gjithë periudhën e marrë në analizë, 2004 – 2009. Në këtë logjikë, vëllai i subjektit*

duket se ka realizuar të ardhura të tjera që i kanë mundësuar atij jetesën dhe mbështetjen për familjarët e origjinës në Shqipëri. Për pasojë, do të ishte jorealiste nëse do vlerësohej ngushtësisht kjo mundësi për t'i dhënë këto para jashtë një vlerësimi logjik e të arsyeshëm brenda kontekstit të marrëdhënieve familjare shumë të afërta e dhënies së një shume përgjithësisht me një efekt relativ në jetesën e një individi”.

66.6 Subjekti shpjegon se duke qenë se ka provuar se dhuruesi ka disponuar mjaftueshëm të ardhura për të dhënë dhuratën, për pasojë, gjetja e Komisionit se “*Ngrihen dyshime për veprime fiktive të subjektit me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme, të cilat subjekti i përdor në vitet në vijim për investime*” është e pabazuar, kjo bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, dokumentacionit bashkëlidhur këtyre prapësimeve, si dhe jurisprudencën se trupave të rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisioni

67. Komisioni, pasi mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, arrin në konkluzionin se:

67.1 Dhuruesi Sh.G ka disponuar tokë bujqësore referuar vërtetimit të datës 20.3.2024, lëshuar nga Njësia Administrative Gj, sipas të cilit konfirmohet se ky shtetas në bazë të ligjit për tokën ka përfituar 4.600 m² tokë, të cilën e ka kultivuar me kultura të ndryshme bujqësore që nga viti 1994 deri në vitin 2004. Kësaj prone i ka paguar rregullisht taksat vendore. Në vijim, rezulton se shtetasi Sh.G.G, banor në Peqin, ka tokë në përdorim dhe që nga viti 1994 figuron si i vetëpunësuar në bujqësi me nr. ***. Kontributet kanë rezultuar të derdhura sipas viteve, për periudhën 1999 – 2004.

67.2 Gjithashtu, subjekti ka provuar me vërtetim të lëshuar nga ISSH-ja për të ardhurat e realizuara nga znj. P.G për periudhën janar 2005 – dhjetor 2005, ku provohet se kjo shtetase ka qenë e punësuar tek shoqëria që ka punuar dhuruesi.

67.3 Komisioni ka reflektuar në analizën financiare, një pagë neto minimale si i vetëpunësuar në bujqësi, si dhe pagat neto të bashkëshortes, duke rezultuar me një balancë negative në shumën – 216.012 lekë.

67.4 U konkludua se dhuruesi nuk kishte burime të mjaftueshme financiare për dhuratën në shumën 3.000 euro.

67.5 Në lidhje me dyshimin e Komisionit për veprime fiktive të subjektit me qëllim justifikimin e burimeve të ligjshme, subjekti nuk e përmbysi barrën e provës dhe për Komisionin fakti që dhuruesi përfundimisht rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme, për dhënien e kësaj huaje e rëndojnë pozitën e subjektit, në këtë aspekt.

68. Depozita në emër të bashkëshortes në Tirana Bank

68.1 Gjatë hetimit administrativ rezultoi se bashkëshortja e subjektit E.G ka pasur një depozitë në Tirana Bank gjatë periudhës 2003 – 2004. Nga Komisioni u evidentua se subjekti referuar ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin e kontrollin e pasurive...”, ka pasur detyrim ta deklaronte këtë depozitë në deklarimin e parë të pasurisë.

68.2 Nga verifikimi i statement bankar evidentohet se në datën 26.11.2003 është bërë një depozitim *cash* në shumën 4.000.000 lekë me përshkrimin në statement “Depozitim në arkë E.G”. Po në këtë datë, shuma ka kaluar në depozitë ku ka qëndruar e tillë deri në datën

25.4.2004 kur shuma bashkë me interesat e akumuluar deri në atë datë është tërhequr *cash* me përshkrimin “Tërheqje para, B.I”.

68.3 Shtetasi B.I/vjehri i subjektit, shumën e tërhequr e ka depozituar më pas *cash* në llogarinë në emrin e tij në muajin mars 2004 dhe e ka mbajtur depozitën në emrin e tij deri në datën 6.1.2006 kur ka tërhequr po *cash* shumën totale prej 4.396.500 lekësh, ku shuma 396.500 lekë janë interesat e përfituar në vite.

68.4 Në lidhje me këtë llogari, si dhe burimin e krijimit dhe destinacionin e shumës Komisioni e ka pyetur subjektin, i cili ka shpjeguar⁶⁵ se: *“Kjo llogari nuk është as e E dhe as në emër të saj. Kjo llogari është e babait të E të ndjerit B.I. Ka qenë një kërkesë e punonjësve të bankës, të cilët kanë kërkuar shoqërimin e titullarit të llogarisë që do të hapej edhe nga një person tjetër i familjes (për shkak të moshës së tij). Gjithashtu, në mandatin e lëshuar nga banka për çeljen e kësaj llogarie ka nënshkruar vetë z. B dhe nuk ka nënshkruar bashkëshortja ime, pavarësisht faktit se në mandat është shënuar nga punonjësi i bankës dhe emri i E, por që nuk shoqërohet me asnjë nënshkrim të saj, fakt që provon se llogaria është krijuar prej babait të saj.*

Për disa muaj E ka pasur të drejtën për të kryer veprime në llogari së bashku me B, por më pas veprimet në llogari kanë kaluar totalisht në të drejtën e z. B. Për të provuar këtë fakt dëshiroj të theksoj se bashkëshortja nuk ka kryer asnjë veprim në këtë llogari. Të gjitha veprimet bankare janë kryer nga i ati i saj.

Gjithashtu dua të theksoj se kjo llogari apo shumat e kësaj llogarie nuk janë përdorur nga ana e familjes sime për asnjë lloj veprimi ekonomik, financiar apo për ndonjë transaksion. Shumat e kësaj llogarie janë disponuar tërësisht dhe në mënyrë të pavarur nga vetë titullari i llogarisë B”.

68.5 Subjekti ka depozituar bashkëlidhur mandatet ku duket se depozitimi në llogari në datën 26.11.2003, si dhe tërheqja në janar 2006 janë firmosur nga shtetasi B.I. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me burimin apo destinacionin e kësaj shume nga ana e z. I.

68.6 Komisioni, në datën 14.11.2023, i është drejtuar Tirana Bank me shkresë ku i kërkohet depozitimi i dokumentacionit shoqërues të transaksioneve në këtë llogari në emër të bashkëshortes së subjektit.

68.7 Tirana Bank⁶⁶ ka informuar se znj. E.B.G ka pasur llogari pranë Tirana Bank me nr. ***, aktive në periudhën 2003 – 2004, në të cilën ka pasur të drejtë veprimi shtetasi B.I.

68.8 Nga verifikimi i të dhënave bankare është evidentuar se veprimet me këtë llogari janë kryer vetëm nga shtetasi B.I/vjehri i subjektit. Në vitin 2006, kjo shumë bashkë me interesat është tërhequr tërësisht nga z. I.

68.9 Komisioni ka evidentuar gjithashtu se kjo shumë nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* apo gjatë hetimit si burim për krijimin e ndonjë pasurie.

68.10 ASHK-të e rretheve nuk kanë depozituar të dhëna për pasuri në pronësi të B apo Z.I.

⁶⁵ Në përgjigje të pyetësorit ardhur me shkresën datë 13.11.2023.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 21.11.2023.

68.11 ISSH-ja⁶⁷ ka depozituar të dhëna për:

- B.I ka përfituar pension pleqërie në periudhën 1990 – 2018, me masë përfundimtare 18.288 lekë, si dhe pension suplementar ushtarak për periudhën 2016 – 2018, në masën 5098.
- Z.I ka përfituar pension pleqërie në periudhën 1990 – 2018, me masë përfundimtare 18.237 lekë.

68.12 Në vijim të analizimit të mundësive për krijimin e depozitave në vitet 2001 – 2003, rezultoi se subjekti ka një balancë negative në shumën 1.986.622 lekë deri në muajin shtator 2003. Për pasojë, subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk do të kishin burime të ligjshme gjatë periudhës shtator – nëntor 2003 për depozitim të shumës 4.000.000 lekë, duke rezultuar e gjithë shuma si balancë e shtuar negative.

68.13 Nga sa më sipër, Komisioni e ka konsideruar shumën 4.000.000 lekë si likuiditet i bashkëshortes në analizën e përgjithshme si depozitë (pasuri) të saj në vitin 2003. Pas transferimit në llogarinë e babait të kësaj shume, është konsideruar në analizë si shpenzim në vitin 2004.

Konstatime të Komisionit

69. Për depozitën në Tirana Bank:

- subjekti nuk e ka deklaruar këtë depozitë në deklaratat vjetore periodike;
- nga hetimi ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka hapur fillimisht llogarinë së bashku me babain e saj me të drejtë veprimi dhe jo e anasjella, sikurse pretendohet nga subjekti;
- nga dokumentacioni në dosje as bashkëshortja e subjektit dhe as prindërit e saj nuk kanë pasur mundësi për të krijuar me burime të ligjshme shumën 4.000.000 lekë në depozitën pranë Tirana Bank.

69.1 Në lidhje me këto konstatime të Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar burimet e ligjshme të depozitës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pika 5 e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimet e subjektit të rivlerësimit

70. Subjekti për depozitën në Tirana Bank ka mbajtur të njëjtin qëndrim si gjatë hetimit ku, ndër të tjera, ka shpjeguar si vijon:

70.1 Depozita është hapur gjatë kohës që bashkëshortja nuk jetonte me prindërit e saj dhe ishte në një ekonomi të përbashkët me subjektin që prej vitit 1997, kur kanë lidhur martesë. Subjekti ka sqaruar se bashkëshortja nuk e ka deklaruar këtë llogari bankare në DPV-të e viteve 2003 dhe 2004, referuar ligjit nr. 9049/2003, “Për deklarimin e kontrollin e pasurive..”, për shkak se kjo gjendje likuiditeti në llogarinë bankare ka qenë e babait të saj.

70.2 Nga verifikimi i dokumentit bankar evidentohet se në datën 24.11.2003 është çelur një depozitë “*Joint account*”, depozitë e përbashkët e shtetasve E.G me B.I dhe kjo kontratë është nënshkruar vetëm nga aplikanti, shtetasi B.I. Nga statement bankar evidentohet se në datën 26.11.2003 është bërë një depozitim *cash* në shumën 4.000.000 lekë, me përshkrimin në statement “Depozitim në arkë E.G”. Po në këtë datë, shuma ka kaluar në depozitë ku ka

⁶⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2021.

qëndruar e tillë deri në datën 25.4.2004 kur shuma bashkë me interesat e akumuluar deri në atë datë është tërhequr *cash* me përshkrimin “Tërheqje para, B.I”.

70.3 Formulari i aplikimit për hapjen e kësaj llogarie është nënshkruar nga vjehri dhe të gjitha veprimet në këtë llogari janë kryer prej tij dhe asnjë veprim nga bashkëshortja e subjektit, e cila me këshillën e punonjësve të bankës ka pranuar thjesht të ketë akses në këtë llogari për shkak të moshës së babait të saj.

70.4 Subjekti shpjegon se tërheqja e kësaj shume është kryer individualisht prej vjehrit në vitin 2004. Depozitimi i kësaj shume ka kaluar më pas në një llogari personale të tij. Shuma është tërhequr nga vjehri në vitin 2006 dhe një pjesë e kësaj shume është depozituar në një llogari tjetër personale prej tij. Siç rezulton nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ pas tërheqjes së kësaj shume në janar vitin 2006, një vlerë në shumën 1.000.000 lekë është depozituar përsëri në llogarinë bankare të babait të bashkëshortes në Credins Bank.

70.5 Kjo vlerë monetare nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie ndër vite të familjes së subjektit, fakt që vërteton tej çdo dyshimi se kjo llogari bankare nuk është e bashkëshortes së subjektit, por e babait të saj dhe, në të tilla kushte, vjehri nuk është person i lidhur dhe as person tjetër i lidhur me subjektin, pasi nuk bien në kategorinë e personave të lidhur me subjektin, në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Për këtë shkak, subjekti ka vlerësuar se nuk ka detyrimin për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të depozituara në këtë llogari.

70.6 Pavarësisht nga sa më sipër, nga informacioni i marrë nga bashkëshortja nga të afërmit e saj rezulton se burimi i të ardhurave në këtë llogari janë të ardhurat familjare të të gjithë anëtarëve të familjes I, duke përfshirë këtu kunatën emigrante në SHBA dhe kunatin emigrant në Greqi që prej vitit 1992. Bashkëlidhur këtyre prapësimeve gjendet edhe certifikata familjare e shtetasit B.I, në këtë kohë ku ai ka qenë në një certifikatë familjare me dy fëmijët e tij, T.I (L) dhe A.I. Subjekti, gjithashtu, ka depozituar disa dokumente që ka mundur të disponojë në lidhje me të ardhurat e ligjshme të kunatës dhe kunatit⁶⁸. Nga aktet e administruara, përfshirë edhe faktin që edhe kunati dhe kunata e subjektit kanë qenë në një ekonomi të përbashkët familjare me prindërit e tyre dhe kanë emigruar që në fillim të viteve ‘90, rezulton tej çdo dyshimi se kjo pasuri nuk është pasuri e bashkëshortes së tij, por e babait të saj.

70.7 Shtetasja T.L, e cila është vajza e shtetasit B.I⁶⁹, shtetase amerikane dhe banuese në New Jersey prej vitit 1997, deklaron se ka dërguar kursimet e saj prindërve në Shqipëri në periudhën 1997 – 2003. Gjithashtu, deklaron se babai ka administruar kursimet e saj. Të ardhurat nga paga e saj në vitin 2001 kanë qenë 17.115 USD, në vitin 2002 të ardhurat kanë qenë 24.670 USD dhe në vitin 2003 të ardhurat kanë qenë 28.176 USD (deri në tetor kanë qenë 23.480 USD).

⁶⁸ Dokumentet për të provuar burimin e depozitës së z. B.I:

- dokumente të dërguara nga SHBA, kunata shtetësja T.L – kopje të deklaratave individuale për të ardhurat personale të krijuara në periudhën 1997 – 2003;
- *email* i dërguar prej saj në adresën time elektronike, në të cilin ajo deklaron se ka përfituar edhe të ardhura të tjera nga bakshishet apo klientët e saj në shtëpi;
- dokumente të dërguara nga vëllai i bashkëshortes nga viti 2002, për të ardhurat e dokumentuara prej tij në Greqi vetëm për periudhën kur këto të ardhura janë të dokumentuara në formë elektronike;
- *email* i dërguar prej vëllait të bashkëshortes në adresën time elektronike, në të cilin ai deklaron se ka përfituar të ardhura nga viti 1992, ku ai ka qenë emigrant në Greqi.

⁶⁹ Referuar certifikatës familjare të datës 4.3.2024 për gjendjen familjare deri në datën 31.12.1978.

70.8 Për sa rezulton, shtetasja T.L, vajza e shtetasit B.I, ka pasur mundësi financiare për kursim në periudhën 2001 – tetor 2003, në shumën 5.040.819 lekë. Mundësi financiare që tejkalon shumën e depozituar në vlerën 4.000.000 lekë në Tirana Bank.

70.9 Shtetasi A.I, i cili është djali i shtetasit B.I, ka realizuar të ardhura në shtetin grek. Referuar dokumentacionit për të ardhurat mujore të realizuara, evidentohet se gjatë vitit 2002 të ardhurat kanë qenë në shumën 6.082,45 euro dhe në vitin 2003 kanë qenë 6.543,55 euro. Bazuar në këto të ardhura të përfituara, rezulton se mundësia për kursim në vitet 2002 dhe 2003 ka qenë në shumën 427.667 lekë.

70.10 Në vijim, subjekti ka shpjeguar se shtetasi B.I ka përfituar pension pleqërie në periudhën 1990 – 2018, me masë përfundimtare 18.288 lekë, si dhe pension suplementar ushtarak për periudhën 2016 – 2018, në masën 5098; Z.I ka përfituar pension pleqërie në periudhën 1990 – 2018, me masë përfundimtare 18.237 lekë. Shtetasi B.I dhe bashkëshortja e tij Z.I, në momentin e depozitimit të shumës kanë qenë në marrëdhënie pensioni. Të ardhurat e përfituara nga pensioni, të cilat janë konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 18.3.2024, kanë përballuar shpenzimet jetike dhe nevojat personale për jetesë.

70.11 Si përfundim, subjekti ka pretenduar se fëmijët e shtetasit B.I kanë pasur mundësi financiare për të kursyer dhe dërguar të ardhura prindërve të tyre, të cilat përbëjnë shumën e depozituar prej shtetasit B.I në vlerën 4.000.000 lekë.

70.12 Subjekti ka pretenduar se përveç sa më sipër, Komisioni duhet të mbajë në vlerësim se këto janë të ardhurat e dokumentuara vetëm për një periudhe të shkurtër kohore dhe me dokumente të ligjshme nga motra dhe vëllai i bashkëshortes, por ata kanë emigruar që në fillim të viteve ‘90 dhe, për këtë arsye, Komisioni duhet të arrijë në konkluzion se tej çdo dyshimi të arsyeshëm kjo pasuri nuk është e bashkëshortes së subjektit, por e babait të saj dhe, për këtë arsye, vlera e këtij likuiditeti nuk duhet të përfshihet në analizën financiare të asnjë viti.

Vlerësimi i Komisionit

71. Komisioni, pasi mori në shqyrtim pretendimet e subjektit, si dhe provat e depozituara prej tij në lidhje me depozitën e çelur në Tirana Bank, në shumën 4.000.000 lekë, për të bërë një analizim të saktë të situatës ka vlerësuar rrethanat vijuese:

71.1 Evidentohet se në Tirana Bank në datën 26.11.2003, është bërë një depozitim *cash* në shumën 4.000.000 lekë, me përshkrimin në statement “Depozitim në arkë E.G”.

71.2 Ndryshe nga sa është deklaruar nga subjekti, bashkëshortja e tij në këtë llogari bankare dyemërore është në cilësinë e depozituesit/titullares së llogarive bankare dhe jo “person i besuar/autorizuar”, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, duke pasur kështu detyrimin ligjor për deklarimin e tyre, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, i ndryshuar.

71.3 Ndryshe nga çfarë ka shpjeguar subjekti se kjo depozitë është çelur si një depozitë dyemërore, për shkak të moshës së vjetër të vjehrrit, si një kërkesë e bankës, ky pretendim është i pabazuar pasi nga hetimi rezultoi që z. I e ka tërhequr këtë depozitë totalisht dhe e ka

disponuar nga viti 2004 e në vijim në një depozitë personale, pavarësisht moshës së tij të vjetër.

71.4 Subjekti, gjithashtu, ka pretenduar se shumat e depozituara⁷⁰ prej tij në Alpha Bank në vitin 2001, i janë transferuar përkohësisht shtetasit B.I, për shkak se ai kishte aplikuar për t'u pajisur me vizë amerikane, ky pretendim bëhet i pabesueshëm për Komisionin, kur vlerësohen rrethanat se:

- subjekti nuk e ka deklaruar depozitën e tij në Alpha Bank në deklarin e parë të tij në vitin 2003 dhe as depozitën e bashkëshortes me babain në Tirana Bank;
- shtetasi B.I në atë periudhë ka disponuar mjaftueshëm të ardhura në depozitën e tij në Tirana Bank dhe nuk i nevojiteshin paratë që i ka transferuar E.G, sikurse ka shpjeguar subjekti⁷¹.

71.5 Në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, në raport me situatën faktike dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues vlerëson se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, *de jure*, ka vepruar në cilësinë e depozitueses/titullares së llogarisë bankare dyemërore me z. B.I, pasi, sipas të dhënave të formularit të llogarisë, të nënshkruar me Tirana Bank, znj. E.G është në cilësinë e palës depozituese në këtë kontratë⁷². Në referencë të nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit Civil, i cili parashikon se *pjesët e bashkëpronarëve janë të barabarta, gjersa nuk vërtetohet e kundërta*, pjesa takuese e znj. E.G në këtë depozitë është 50% e saj. Bazuar në këto parashikime kontraktore dhe ligjore, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka qenë në cilësinë e depozitueses në këto llogari bankare, duke gëzuar të njëjtat të drejta e detyrime për to, si edhe titullari tjetër, z. B.I.

71.6 Nga Komisioni është konstatuar se prindërit e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit nuk kanë vërtetuar me dokumentacion provues aftësinë financiare të tyre për të krijuar këtë depozitë (në pjesën takuese prej ½). Subjekti ka pretenduar se për krijimin e depozitës janë përdorur të ardhurat e krijuara nga emigracioni i fëmijëve të tij në Greqi dhe SHBA, për të cilat ka depozituar⁷³ të dhëna. Këto pretendime të subjektit nuk janë deklaruar më parë gjatë

⁷⁰ 3.000.000 lekë.

⁷¹ Në përgjigjet e pyetësorit ardhur me emailin e datës 20.9.2023.

⁷² Sipas parashikimeve të kësaj kontrate rezultojnë se: *"Depozita do të përshkruhet nga dispozitat e ligjit që ka lidhje me "depozitat në llogari të përbashkët". Kjo do të thotë se, kushdo nga përfituesit e mësipërm të depozitës që mund të përdorë llogarinë, tërësisht ose pjesërisht, pa qenë i nevojshëm bashkëveprimi i të tjerëve. Gjithashtu, secili nga përfituesit e depozitës do të ketë të drejtën e përdorimit të pjesshëm ose të plotë të llogarisë pa bashkëveprimin, pëlqimin dhe miratimin e përfituesve të tjerë, madje dhe në rastin e tërheqjes së parakohshme nga depozita me afat ose me paralajmërim, natyrisht mbasi tërheqja e parakohshme pranohet nga banka. Është e kuptueshme se çdo depozitim i ri në llogarinë e mësipërme do të përshkruhet nga kushtet e këtij dokumenti pa qenë deklarata e veçantë. Në rast vdekjeje të cilitdo nga përfituesit, kjo depozitë, si dhe e gjithë llogaria do të kalojë tek përfituesit e tjerë që janë gjallë deri tek i fundit".*

⁷³ Akte të depozituara nga subjekti i rivlerësimit:

- vërtetim nga Tirana Bank nr. ***, datë 13.3.2024, i cili ka të bashkëlidhur kontratën e mbylljes së llogarisë në datën 25.3.2004 (6 fletë);

- mandatat "Depozitë në arkë" e datës 24.11.2003; "Tërheqje nga arka" e datës 25.3.2004; "Depozitë në arkë" e datës 25.3.2004, mandati "S.W.s" i datës 6.1.2006 dhe certifikatë e depozitës me afat (5 fletë);

- të ardhurat nga motra e bashkëshortes znj. T.L (I) në SHBA;

- kopje pasaporte e noterizuar e T.L (Y);

- sqarim me email nga T.L (Y) lidhur me të ardhurat në SHBA për periudhën 1997 – 2003;

- vërtetim të ardhurash për vëllain e bashkëshortes, A.I;

- sqarim me email nga A.I lidhur me të ardhurat nga puna nga viti 1992 në Greqi (2 fletë);

- dokumente të ndryshme të vëllait të bashkëshortes si kopje e pasaportës së vitit 1997 në të cilën pasqyrohet viza për në Greqi, kopje e pasaportes të lëshuar në vitin 2000, leje pune dhe leje qarkullimi;

- foto të ndryshme të dërguara nga vëllai i bashkëshortes me të cilën kërkon të provojë punën e tij në Greqi (10 fletë);

- vërtetim nr. ***, datë 18.3.2024, për të ardhurat nga pensioni i pleqërisë dhe suplementar si ushtarak për babain e bashkëshortes B.I nga vitet 1990 – 2018 (4 fletë) dhe vërtetim me të njëjtën nr. protokollin dhe datë për të ardhurat nga pensioni i pleqërisë për nënën e bashkëshortes Z.I;

- certifikatë familjare e B.I "Gjendje familjare e vitit 1978";

hetimit dhe duket sikur janë sjellë pas kalimit të barrës së provës dhe në funksion të rezultateve të këtij hetimi. Gjithashtu, fëmijët e shtetasit B.I, me të ardhurat që kanë provuar me dokumente duket sikur kanë punuar për të mbushur depozitën e prindërve.

71.7 Nga analiza financiare që kreu Komisioni rezultoi se edhe subjekti i rivlerësimit me bashkëshorten nuk kanë disponuar të ardhura të mjaftueshme për të krijuar shumën e depozitës apo edhe pjesën takuese të bashkëshortes ½ e saj. Për Komisionin, fakti që subjekti nuk ka deklaruar asnjë nga depozitat e çelura në bankat e nivelit të dytë, fakti që kryen veprime me vjehrrin, transfertat apo tërheqjet e këtyre shumave prej vjehrrit, faktin që këto depozita tërhiqen të dyja në vitin 2006 kur subjekti ka kryer investimin më të madh tek ndërtimi i shtëpisë 2 kate, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana të orientojnë tek përdorimi i kësaj depozite nga ana e familjes së subjektit.

71.8 Komisioni konkludoi se subjekti nuk arriti të përmbysë barrën e provës në rezultatet paraprake të hetimit administrativ të Komisionit dhe familja e subjektit rezultoi në pamundësi financiare për të krijuar depozitën e çelur në Tirana Bank.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

72. Në përfundim, pas vlerësimit të shpjegimeve të subjektit dhe dokumentacionit të depozituar prej tij, për periudhën e analizuar 1995 – 2016, balanca totale negative do të ndryshojë nga - 9.454.496 lekë në - 8.200.000 lekë.

PERSHKRIMI	PASURI	DETYRIME	PASURI NETO	TË ARDHURA	SHPENZIME	REZULTATI
1995 – 2002	3 660 896	-	3 660 896	4 979 512	2 108 475	- 789 859
2003	5 197 104		5 197 104	1 109 912	381 892	- 4 469 084
2004	290 044	-	290 044	1 392 986	575 171	527 771
2005	3 001 524	-	3 001 524	1 286 253	620 748	- 2 336 019
2006	- 3 256 668		- 3 256 668	1 291 810	5 074 086	- 525 608
2007	5 741 278	-	5 741 278	7 104 992	582 501	781 213
2008	208 028	-	208 028	1 360 707	1 074 480	78 199
2009	641 021	-	641 021	1 497 418	643 280	213 118
2015	4 963 652	-	4 963 652	6 512 663	564 096	984 915
2016	453 776	-	453 776	2 074 609	1 208 879	411 954

72.1 Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se:

i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë *Vetting*, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, në shumën rreth 8.2 milionë lekë, referuar parashikimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

-
- certifikatë familjare e B.I "Gjendje familjare e vitit 1997";
 - certifikatë familjare e B.I "Gjendje familjare e vitit 2000";
 - certifikatë familjare e B.I "Gjendje familjare e vitit 2009";
 - certifikatë familjare e Dritan Gripshit "Gjendje familjare e vitit 1997";
 - të dhëna nga sistemi TIMS për udhëtimet e B.I.

iii. Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, duke u gjendur nën parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, të cilat përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. KONTROLLI I FIGURËS

73. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (referuar si AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikojë nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.
74. AKSIK-ja ka dërguar raportin në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016⁷⁴ mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ku ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi në detyrën e prokurorit.

Vlerësimi i Komisionit

75. Komisioni ka kërkuar përditësim të raportit të dërguar nga AKSIK-ja në vitin 2017, për të cilin kemi marrë përgjigje se disponohen informacion shtesë për periudhën 2020 – 2022.
76. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.
77. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

78. Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në analizimin e:
- raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë⁷⁵ (këtu e në vijim referuar si KLP) për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
 - kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij);
 - denoncimeve të paraqitura nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.
79. Vlerësimi profesional për subjektin e rivlerësimit është kryer nga KLP-ja, i cili ka hartuar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, bazuar në:
- formularin e vetëdeklarimit;

⁷⁴ Raporti mbi kontrollin e figurës për subjektin me nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 27.3.2023.

⁷⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 17.12.2020.

- 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit, të dhënat nga burimet arkivore;
- 5 dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

GJETJET NGA FORMULARI I VETËVLERËSIMIT DHE DOKUMENTET E PARAQITURA NGA SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT

80. Nga tri dokumentet e depozituara nga subjekti dhe pesë dosjet e vëzhguara të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika lidhur me vlerësimin profesional të subjektit Dritan Gripshi, në cilësinë e prokurorit.

TË DHËNAT ARKIVORE

Ankesat dhe masat disiplinore – vlerësimet

81. Nga verifikimi në arkivin e Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë konstatohet se ndaj prokurorit Dritan Gripshi janë marrë dy masa disiplinore, konkretisht:

81.1 Me urdhrin nr. **, datë 21.3.2001, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, për mosparaqitje të prokurorit në seancat gjyqësore pa shkaqe të arsyeshme.

81.2 Me urdhrin nr. **, datë 24.2.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm, është pezulluar nga detyra e prokurorit, pasi ndaj tij është regjistruar procedimi penal nr. **/2003 për veprën penale “Refuzimi për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur ose nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, mbi bazën e kallëzimit penal të ILDKPKI-së.

81.3 Pas hetimeve të kryera nga Prokuroria e Rrethit Librazhd, ku në datën 7.6.2006, është vendosur pushimi i çështjes penale me urdhrin nr. ***, datë 4.9.2006, të Prokurorit të Përgjithshëm, është ndërprerë pezullimi për subjektin e rivlerësimit dhe është rikthyer në detyrën e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

81.4 Me urdhrin nr. ***, datë 19.11.2009, të Prokurorit të Përgjithshëm, ishte filluar procedimi disiplinor mbi bazën e aktkontrollit të ushtruar për mosfillimet, procedimet penale të pushuara, çështjet e dërguara në gjyq dhe të gjykuara për vitet 2007 – 2008 e ato të mbartura për vitin 2009, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës. Me Dekretin nr. ***, datë 29.6.2010, të Presidentit të Republikës, prokurori Dritan Gripshi është shkarkuar nga detyra si prokuror mbi bazën e propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm.

81.5 Mbi bazën e ankimit të prokurorit Dritan Gripshi, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. ***, datë 24.10.2014, ka vendosur shfuqizimin e Dekretit të Presidentit dhe rikthimin në detyrë në pozicionin e prokurorit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat.

81.6 Në zbatim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, me vendimin nr. **, datë 29.1.2015, të Prokurorit të Përgjithshëm, prokurori Dritan Gripshi është rikthyer në detyrë.

81.7 Subjekti i rivlerësimit, prokurori Dritan Gripshi, është vlerësuar “Shumë mirë”, sipas aktit të lëshuar nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2015 dhe 2016.

ANALIZA E GJETJEVE⁷⁶

82. Referuar raportit të hartuar nga KLP-ja, akteve të përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short shqyrtuar nga Komisioni, ka rezultuar se subjekti është vlerësuar pozitivisht në lidhje me:
- aftësitë profesionale/njohuritë dhe arsyetimin ligjor;
 - aftësitë organizative të treguara gjatë ushtrimit të detyrës;
 - aftësitë personale dhe angazhimi profesional;
 - etikën në punë dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale.

DENONCIME NGA PUBLIKU

83. Për subjektin e rivlerësimit Dritan Gripshi janë administruar në total 8 denoncime, 3 prej të cilave janë të përsëritura. Në lidhje me 2 denoncime Komisioni ka evidentuar si vijon:
- 84. Denoncim depozituar⁷⁷ nga shtetasi R.M,** i cili ka ngritur pretendime për subjektin e rivlerësimit Dritan Gripshi lidhur me veprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrës, si prokuror i çështjes me kallëzues shtetasin R.M.

84.1 Denoncuesi ka pretenduar se është përfshirë në një situatë mashtrimi nga shtetasi J. B (me detyrë koordinator në Drejtorinë e Policisë Rrugore) dhe babait të tij F.B, me detyrë kryetar i komunës dhe kryetar i KRRT-së së Komunës Vertop, Berat. Të dy këta shtetas i kanë shitur denoncuesit 2 prona në komunën Vertop, ku në këto prona denoncuesi mund të ndërtonte një pikë karburanti. Dy shtetasit J dhe F (babë e bir) e kanë siguruar denoncuesin R.M se në truallin ku ndodheshin pasuritë që i shitën denoncuesit ishin miratuar lejet e nevojshme për ndërtimin e pikës së karburantit. Leja e ndërtimit të karburantit ishte lëshuar nga kryetari i komunës që ishte shtetasi F.B, si dhe në këmbim të kësaj lejeje ndërtimi të miratuar i kanë kërkuar (babë e bir) si shpërblim edhe një shumë *extra* prej 30.000 euro.

84.2 Pasi denoncuesi ka nisur ndërtimin në pasuritë e blera është përballur me situatën në të cilën nuk mund të kryente ndërtimin, si dhe i rezultoi se të dyja pronat i kishte blerë me çmim shumë më të madh se çfarë vlenin, por gjithashtu se ishte mashtruar dhe kishte paguar edhe shumën prej 30.000 euro, për lejen e ndërtimit e cila kishte rezultuar e pavlefshme. Sipas denoncuesit, shtetasi J.B nuk i dispononte paratë për t'ia kthyer, por në këmbim të kësaj shume i kishte ofruar 200 g lëndë narkotike e llojit “kokainë” që denoncuesi të mund ta shiste.

84.3 Prokurori i çështjes ka qenë subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi, i cili më 2.9.2019 ka regjistruar procedimin penal në ngarkim të personit nën hetim J.B, për veprat penale “Mashtrimi” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 143 dhe 248 të Kodit Penal.

84.4 Denoncuesi ka shpjeguar se subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi nuk ka kryer detyrën e tij funksionale pasi prokurori pa kryer një hetim të gjithanshëm të çështjes dhe pa pyetur të dëmtuarin akuzues/denoncuesin i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat për pushimin e çështjes penale nr. ***, në ngarkim të shtetasit J.B, për veprat penale

⁷⁶ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

⁷⁷ Me nr. *** prot., datë 27.4.2022 dhe nr. *** prot., datë 26.4.2022.

“Mashtrimi” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara nga nenet 143 dhe 248 të Kodit Penal.

Konstatime të Komisionit

85. Nga analizimi i akteve të fashikullit penal nga Komisioni, rezultoi se nga subjekti i rivlerësimit, gjatë hetimit të çështjes prej tij në vitin 2019 nuk janë kryer veprimet hetimore të nevojshme për zbardhjen e çështjes, si njoftimi e thirrja e personit që ka dijeni për ngjarjen R.M, pyetja e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime shtetasit J.B, etj. Këto veprime hetimore, të cilat nuk u kryen nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit, janë lënë si detyra nga Gjykata e Apelit Vlorë në vendimin e saj nr. **, datë 22.10.2020.
86. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

87. Në lidhje me denoncimin e depozituar nga shtetasi R.M, subjekti në përgjigje të rezultateve të hetimit ka shpjeguar se kjo çështje është filluar nga Prokuroria e Krimeve të Rënda dhe më pas është shpallur moskompetenca prej tyre dhe është dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Këto veprime nuk ishin kryer më parë dhe prej këtyre dy institucioneve. Subjekti ka shpjeguar se me lënien e detyrave nga Gjykata e Apelit Vlorë ka përmbushur këto detyra të cilat janë konstatuar edhe nga Komisioni si vijon:

87.1 I është bërë ftesë për paraqitjen e shtetasit R.M në bazë të neneve 318-312 të Kodit të Procedurës Penale. Më pas është urdhëruar thirrja e tij në bazë të po atyre neneve dhe më pas është bërë njoftimi me shpallje. Këto njoftime janë bërë me qëllimin e marrjes së të dhënave nga personi që ka dijeni për hetimin, shtetasi R.M. Nga oficeri i policisë gjyqësore J.S është mbajtur procesverbali i personit që nuk gjendet ku aty citohet se ai ndodhet jashtë shtetit. Po kështu, është përpiluar raport-shërbimi nga policia, e cila ka shkuar në banesë dhe nuk e ka gjetur atë dhe ka vënë shënimin se ai gjendet në Itali.

87.2 Njoftimi me shpallje për shtetasin R.M është bërë në bazë të nenit 133 të Kodit të Procedurës Penale, në Bashkinë Poliçan, në institucionin e Prokurorisë së Rrethit Berat dhe në banesën e tij, apartament në Poliçan, ku tek procesverbali i tij ka firmosur nëna e tij, znj. H.M. Nga oficeri i policisë gjyqësore A.B është pyetur nëna e tij, e cila ka deklaruar se djali është jashtë shtetit, por nuk e di shtetin ku ndodhet. Pas këtyre kërkimeve, nga ana jonë është mbajtur procesverbali për mosparaqitjen e R.M për t’u pyetur. Po kështu, nëpërmjet të oficerit të policisë gjyqësorë H.A me urdhërimin e prokurorit është komunikuar me shtetasin R.M dhe i është kërkuar që ai të paraqitet në institucionin e Prokurorisë së Rrethit Berat për të dëshmuar.

87.3 Subjekti ka shpjeguar se me këto akte të hartuara prej prokurorisë, shtetasi R.M konsiderohet i njoftuar. Gjithashtu, nga ana e Prokurorisë është pyetur në datën 3.3.2021 shtetasi J.B, i cili është paraqitur në Prokurori dhe ka dëshmuar në prani të avokatit mbrojtës. Pavarësisht sa më lart, subjekti ka shpjeguar se veprimet hetimore me dy shtetasit e mësipërm, duhet të kryheshin më së pari nga Prokuroria për Krime të Rënda, e cila ka hetuar çështjen për 2 vite e 4 muaj. Megjithatë, siç rezulton nga relatimi i mësipërm, subjekti sqaron se nuk rezulton që prej tij si prokurori i çështjes pas dërgimit të saj për kompetencë nga

Prokuroria për Krime të Rënda dhe ajo e Kavajës të jetë neglizhuar kryerja e këtyre veprimeve hetimore, përkundrazi, ai argumenton se janë marrë masat e përshkruara më sipër për realizimin e tyre.

Vlerësimi i Komisionit

88. Për analizimin e çështjes me kallëzues shtetasin R.M, Komisioni, gjatë hetimit kishte tërhequr dosjen e plotë hetimore nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat⁷⁸, e cila ka depozituar aktet e fashikullit të procedimit penal nr. **, viti 2019.
89. Veprimet hetimore të cituara si të kryera nga subjekti, në prapësime, janë konstatuar nga Komisioni si veprime hetimore të kryera pas detyrave të lëna nga Gjykata e Apelit Vlorë në vendimin e saj nr. **, datë 22.10.2020, ku ka pranuar ankimin e denoncuesit R.M dhe ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 20.7.2020 të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat dhe rrëzimin e kërkesës së prokurorit. Kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, datë 2.9.2019 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Berat, për vazhdimin e hetimeve”*, sipas detyrave të lëna në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, veprime të cilat do të kryhen brenda një muaji.
90. Nga ky vendim rezulton se subjekti nuk kishte kryer një hetim të gjithanshëm të çështjes për të sqaruar ekzistencën e fakteve penale. Gjithashtu, rezultoi që subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit të çështjes, fillimisht gjatë vitit 2019, nuk kishte kryer veprimet hetimore si të thërriste dhe merrte deklaramë nga viktimja R.M dhe pasi të kryente këto veprime hetimore nëse këto fakte do të rezultonin të provuara gjatë hetimit, ai do të formulonte akuzën dhe të paraqiste kërkesën për gjykim ndaj të pandehurit J.B, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” etj.
89. Komisioni vlerëson se veprimet hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. **, datë 22.10.2020, subjekti duhet t’i kishte kryer gjatë hetimit të çështjes në vitin 2019, dhe nuk ka pasur shkaqe të arsyeshme, të cilat ta kenë penguar për të përmbushur detyrat e tij funksionale në zbardhjen e çështjes dhe zgjidhjen e saj përfundimtare.

91. Denoncim i shtetasve⁷⁹ E.T.Q dhe K.Q

91.1 Këta denoncues kanë paraqitur pretendime për subjektin e rivlerësimit Dritan Gripshi, si në vijim.

91.2 Denoncuesja E.Q ka shpjeguar se nga babai i saj kanë trashëguar bashkë me nënën dhe të vëllain (K.Q) në qytetin e Beratit një shtëpi + truall me sip. 153.7 m², në lagjen monumentale “G” të qytetit të Beratit. Pas kryerjes së procedurave ligjore, çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, pasuria u regjistrua në ASHK Berat, vetëm në emër të vëllait të denoncueses K.Q, duke përjashtuar nga trashëgimia denoncuesen dhe nënën e saj.

91.3 Në këto kushte, këto shtetase i janë drejtuar ASHK-së Berat, ku kanë parashtruar situatën ligjore të pronës dhe të drejtën e tyre të bashkëpronësisë me vëllain, si dhe i kanë kërkuar ASHK-së të bëjë rregullimin e certifikatës së pronësisë në emër të 3 bashkëpronarëve të pronës.

⁷⁸ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2024.

⁷⁹ Me nr. **, datë 11.1.2024 dhe nr. **, datë 10.1.2024.

91.4 Pasi ASHK Berat ka bërë korrigjimin dhe shpalljen e vendimit të saj për lëshimin e certifikatës së pronësisë së pasurisë, në emër të 3 bashkëpronarëve ligjorë të pasurisë, pranë ASHK-së Berat është depozituar një ankesë nga shtetasi S.Q (djali i xhaxhait të denoncueses dhe kufitarë në pronë me denoncuesen), me pretendimin se në regjistrimin e pronës së xhaxhait të tij gabimisht është përfshirë edhe një sipërfaqe toke prej 4.7 m², në pronësi të tij. Për këtë arsye, ky shtetas ka kërkuar nga ASHK Berat që të mos bëhej regjistrimi i kërkuar nga E.Q deri në zgjidhjen e konfliktit të tyre.

91.5 Në vijim, për të njëjtën situatë pranë ASHK-së Berat ka paraqitur ankesë z. Dritan Gripshi me pretendimin se ka dakordësuar paraprakisht dhe se është duke kryer procedurat ligjore me shitësin S.Q, për kalimin e pronësisë në favorin e tij si palë blerëse e pasurisë së ndodhur në lagjen “G”, kufitarë me pronën e denoncueses E.Q dhe ka kërkuar që të mos bëhej regjistrimi i pasurisë së kërkuar nga E.Q dhe familja deri në zgjidhjen e konfliktit të tyre.

91.6 Denoncuesit kanë pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka përvetësuar pa të drejtë një pjesë të pronës së tyre, e posedon atë, si dhe duke shfrytëzuar detyrën e tij nuk po lejon regjistrimin e pronës në emër të pronarëve legjitim. Gjithashtu, denoncuesit kanë pretenduar se subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet që të bëjë një kërkesë/ankesë pranë ASHK-së Berat, pasi nuk ka asnjë tagër mbi pasurinë objekt shqyrtimi. Denoncuesit pretendojnë se ankesa e dërguar nga subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi pranë ASHK-së Berat është një presion i bërë në cilësinë e tij si titullar i Prokurorisë së Rrethit Berat ndaj këtij institucioni dhe punonjësve të tij, që këta persona të mos ushtrojnë detyrën. Denoncuesja pretendon që ky prokuror ka si qëllim grabitjen e një pjese të pronës së saj, e cila realisht ishte e regjistruar në emër të babait të saj e më vonë në emër të vëllait.

91.7 Subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pretendimet e denoncueses, iu kërkuar shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

92. Në lidhje me denoncimin e depozituar nga familja Q, subjekti ka shpjeguar se me shtetasin S. Q kishte nënshkruar kontratën për blerjen e një pasurie të paluajtshme në datën 20.11.2023, për një shtëpi në lagjen “G”, Berat. Kjo kontratë me çmim shitjeje prej 4 milionë lekësh do të likuidohej totalisht kur të miratohej kredia bankare në Intesa Sanpaolo Bank etj. Objekti për të cilin pretendon shtetasja E.T.Q është një sipërfaqe prej rreth 4.7 m² dhe posedohej nga shitësi S.Q prej shumë kohësh.

92.1 Për shkak të kësaj marrëdhënieje që subjekti kishte filluar me shitësin, kishte paraqitur ankesë pranë ASHK-së Berat brenda afatit që parashikonte rregullorja e këtij institucioni më 19.12.2023, pra një muaj pas lidhjes së kontratës që e legjitimonte ta bënte këtë kërkesë. Gjithashtu, një ankesë të tillë e kishte paraqitur dhe shtetasi S.Q më 14.12.2023.

92.2 Subjekti ka shpjeguar se pas shqyrtimit të këtyre kërkesave nga ASHK-ja, ky institucion ka marrë vendim për miratimin e kërkesës për kalimin në pronësi të objektit pa truall pronësie, me truall funksional për shtetasen E.Q etj., ku pjesës së pretenduar prej tyre 4.7 m² nuk i është miratuar legalizimi. Kjo tregon që të gjitha veprimet e subjektit kanë qenë të drejta dhe ligjore.

Vlerësimi i Komisioni

93. Komisioni, në shqyrtim të pretendimeve të subjektit, ka analizuar provat⁸⁰ e depozituara prej tij në lidhje me këtë denoncim, ku rezultoi se në muajin nëntor të vitit 2023 ka nënshkruar kontratë shitblerjeje⁸¹ për dy pasuri të paluajtshme me sip. 64 m² secila, të cilat do të paguheshin brenda një afati 1-mujor deri në disbursimin e kredisë. Ka rezultuar se këto prona u regjistruan në emër të subjektit në datën 4.12.2023, referuar certifikatave të regjistrimit të pasurive. Pra, duket se subjekti ka pasur një interes legjitim në paraqitjen e ankesës pranë ASHK-së Berat.
94. Gjithashtu, nuk u vërtetua pretendimi i denoncueses se subjekti i rivlerësimit si titullar i Prokurorisë së Rrethit Berat ka ushtruar presion ndaj institucionit të ASHK-së Berat dhe punonjësve të tij, që këta persona të mos ushtrojnë detyrën.

Gjetje të tjera në lidhje me kriterin profesional

95. Komisioni ka kryer hetim të thelluar referuar të dhënave të raportuara nga organet ligjzbatuese. Komisioni vlerësoi që të analizojë 4 dosje gjyqësore dhe në njërën prej tyre ka evidentuar si vijon:
- 96. Çështja penale e vitit 2016, me të akuzuar shtetasit V.N dhe Y.Z, akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”**

96.1 Prokurori Dritan Gripshi ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 30.6.2015, për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Korrupsion pasiv” në ngarkim të 2 punonjësve të AKU-së.

96.2 Pas gati 2 vite nga regjistrimi i procedimit penal, OPGJ-ja ka mbajtur 2 procesverbale për pyetjen e personave ndaj të cilëve zhvillohen hetimet, shtetasit Y.Z dhe V.N. Të gjitha veprimet e kryera nga organi i akuzës në funksion të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm mund të ishin kryer pa u zgjatur afatet e hetimit 7 herë me nga 3 muaj.

96.3 Subjekti i rivlerësimit në vendimet për zgjatjen e afateve të hetimit ka referuar nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale, të ndryshuar ku është parashikuar se: *“1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj. .. 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t’i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur...”*.

96.4 Komisioni, pas analizimit të akteve të këtij procedimi, ka konstatuar se nuk evidentohet ndonjë kompleksitet i çështjes apo pamundësi objektive që ta ketë penguar subjektin e

⁸⁰ Aktet bashkëlidhur prapësimeve për denoncimin e shtetasës E.Q:

- kontratë shitje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.11.2023 (5 fletë);
- certifikatë regjistrimi pronësie, zona kadastrale ***, Berat, rruga “G” nr. ap. * (1 fletë);
- kartelë pasurie të paluajtshme (2 fletë);
- fragment harte (1 fletë);
- certifikatë regjistrimi pronësie, zona kadastrale ***, Berat, rruga “G” nr. ap. * (1 fletë);
- kartelë e pasurisë së paluajtshme (2 fletë);
- fragment harte (1 fletë);
- vendim nr. 2, datë 21.2.2024 i Drejtorisë Vendore Berat për shtetasen E.Q etj. (4 fletë);
- vendim nr. 2, datë 21.2.2024 i Drejtorisë Vendore Berat për shtetasen E.Q etj. (4 fletë);
- planimetria e katit përdhe (1 fletë);
- ankesë nr. *** prot., datë 19.12.2023 (1 fletë);
- urdhër regjistrimi procedimi penal ndaj shtetasit K;
- akt teknik mbi qëndrueshmërinë dhe riskun e faktorëve aktualë të shtëpisë në lagjen “G”.

⁸¹ Me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.11.2023.

rivlerësimit në përfundimin e çështjes brenda afateve, pa pasur nevojë që të zgjaten këto afate 7 herë.

96.5 Në lidhje me konstatimet e Komisionit për zvarritjen e hetimeve të çështjes dhe zgjatjen e afateve të hetimit 7 herë, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

97. Në lidhje me dosjen e analizuar nga Komisioni, në prapësime subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se zgjatjet e afatit në çështjen penale në ngarkim të shtetasve V. N. dhe Y. Z. kanë pasur si qëllim zgjerimin e hetimit me arsyetimin për të mundësuar gjetjen e provave të tjera në dobi të këtij hetimi, për shkak të natyrës së kësaj veprë, siç është ajo e “Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike”, neni 259 i Kodit të Procedurës Penale. Vepër e cila që të dokumentohet me prova kërkon një hetim më të specializuar me metoda speciale hetimi, siç janë përgjimi ambiental, audioviziv etj., me qëllim gjetjen e provës që në rastin konkret do të ishte mita ose ryshfeti në funksion të kryerjes së detyrës nga zyrtari.

97.1 Ky ka qenë edhe qëllimi i zgjatjes së afateve prej subjektit në mënyrë që të lihej koha e nevojshme që oficeri i policisë të kryente një relacion shpjegues ku të përcaktonte edhe çfarë veprimesh të tjera hetimore do të kryeshin nga ana jonë. Kjo gjë nuk është bërë e mundur për një sërë faktorësh objektivë: e para për faktin se kallëzuesi pretendonte për një veprim të kryer më parë dhe jo për një veprim që pritej të ndodhte.

97.2 Në këtë periudhë duhet të mbahet në konsideratë edhe ngarkesa e lartë vjetore, që për vitin 2015 ka qenë 236 procedime penale, për vitin 2016 310, për vitin 2017 470 procedime, të cilat kanë vështirësuar kontrollin e punës ndaj oficerit të policisë dhe marrjen e një vendimmarrjeje brenda një afati kohor të shkurtër. Subjekti ka shpjeguar se vendimi i është komunikuar kallëzuesit, i cili ka pasur të drejtën e ankimit ndaj tij, po kështu vendimet e zgjatjeve të kryera prej subjektit i janë komunikuar personave në hetim, duke u respektuar të gjitha kërkesat e procedurës penale.

Vlerësimi i Komisionit mbi kriterin e aftësive profesionale

98. Shpjegimet e dhëna nga subjekti në lidhje me zgjatjen e afateve të hetimit për 2 vite rresht, me qëllim gjetjen e provës që në rastin konkret do të ishte mita ose ryshfeti në funksion të kryerjes së detyrës nga zyrtari, janë të papranueshme nga Komisioni, në situatën kur nga institucioni i Prokurorisë për 2 vite rresht nuk është kryer asnjë veprim hetimor, nga ato të cituara nga subjekti në shpjegime, përveçse janë pyetur shtetasin Y.Z dhe V.N, persona ndaj të cilëve janë zhvilluar hetimet. Të gjitha veprimet e kryera nga organi i akuzës në funksion të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm mund të ishin kryer pa qenë e nevojshme zgjatja e afateve të hetimit 7 herë, me nga 3 muaj.

Vlerësimi i aftësive profesionale sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

99. Gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, bazuar në opinionin e Komisionit të Venecias⁸² dhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁸³, të cilët kanë vendosur qartë kufirin ndarës për një vlerësim negativ të aftësive profesionale, i cili bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara që tregojnë mungesë të aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit.
100. Komisioni nuk i çmoi problematikat e evidentuara dhe të trajtuara në këtë vendim si shkaqe që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimeve të nenit E të Aneksit të Kushtetutës apo që ta bëjnë atë të papërshtatshëm në drejtim të aftësive profesionale, në kuptim të nenit 61/4 të ligjit nr. 84/2016.
101. Në përfundim, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të magjistratit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:
- a. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016.
 - b. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
 - c. Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.
 - d. Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Konkluzion lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

102. Bazuar në shkronjën “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Dritan Gripshi nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, në përputhje me nenin 61/3 të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

⁸²Shihni opinionin nr. 824/2015 të Venecias.

⁸³Shihni vendimin nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, referuar në nenit 4, pika 2, nenit 58, pika 1, shkronja “c”, si dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Dritan Gripshi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 27.3.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Genta TAFA (BUNGO)

Kryesuese

Suela ZHEGU

Relatore

Roland ILIA

Anëtar

Sekretare gjyqësore

Etmonda Hoxha